

Samiti Në NATO vetëm si Maqedoni e Veriut

Fq.3



MPB PËRSËRIT APELIN "Sazdovi" të mos politizohet

Fq.5



Kosova, parajsë për kom- panitë serbe

Fq.14



Koha

www.koha.mk



Modriç, dikur u refuzua, sot të gjithë e duan

Fq.22

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3411 · e mërkurë, 11 korrik 2018

17°C | 29°C

15 DEN

FORUM

Impakti gjeopolitik i Marrëveshjes Greqi- Maqedoni



U deshën 27 vite të vështira, të ndërmjetësuar nga OKB-ja për Republikën e Maqedonisë për të siguruar një marrëveshje me Greqinë me një emër të ri. Marrëveshja, e arritur nga dy kryeministrat: Zaev dhe Tsipras, më 17 qershor 2018, hap rrugën për atë që së shpejti do të...

Fq.10

SPECIALE

Çfarë ndodh pas betimit të Erdoganit?

Fq.12

PROFILE

Nga katrahura e vendlindjes në ballë të demonstratave shqiptaro- amerikane

Fq.16



EUFORIA E LOJËRAVE TË FATIT ASSESI TË NDALET

MË SHUMË HARXHOJMË NË BASTORE SE SA PËR BUKË



Totali i të hollave që qytetarët kanë harxhuar për të luajtur baste në zinxhirin më të madh të bastoreve në vend "Sport Lajf" prej afër 83 milionë euro është më i madh se harxhimi i 60 milionë eurove i mishit apo bukës dhe parorive të bardha për një vit

Fq.6

Shkollat shqipe më të dobëta në Shkup

Shkup, 10 korrik - Filloristët e Komunës Qendër kanë marrë vitin e kaluar më shumë pesëshe, e pasuar nga shkollat e Komunës së Karposhit dhe Aerodromit. Nota më të dobëta kanë nxënësit në shkollat fillore të Shuto Orizares dhe Sarajit. Nëse analizohen të dhënat për notat në nivel të Qytetit të Shkupit, del se më së shumti për pesëshe luftojnë nxënësit që mësojnë në Qendër. Atje, në fund të vitit të kaluar

shkollor, mesatarja e notës ka qenë 4.57, në Aerodrom 4.31, në Karposh 4.32. Dysha dhe tresha më shumë kanë marrë nxënësit në Shuto Orizarë, ku mesatarja ka qenë 2.99 dhe në Saraj me mesatare 3.56. Shkolla fillore "Koço Racin" në Qendër ka notë më të lartë mesatare edhe atë 4.75, ndërsa shkolla me nota më të dobëta është "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid" nga Shuto Orizarja me notë mesatare 2.99...

Fq.8



EDITORIAL

OKUPIMI SERB I
EKONOMISË KOSOVARE

Emin AZEMI

Mediat kosovare para dy viteve publikuan një dokument "Top Sekret" të Shërbimit Sekret të Serbisë (BIA) që kishte të bënte me strategjinë e Beogradit në fushën e ekonomisë, ku parashiheshin masa konkrete për depërtimin agresiv të Serbisë në tregun e Kosovës dhe paralizimin e ekonomisë së kësaj të fundit. Ky dokument sekret burim shqetësues kishte pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, prej kur kishte filluar rënia drastike e eksportit të produkteve serbe në Kosovë.

"Kompanitë lokale përgjithësisht kanë prodhuar produkte që mund të krahasohen me prodhimet tona, edhe sipas përmbajtjes edhe sipas dizajnit, kështu që gradualisht po e fuqizojnë praninë e tyre në dëm të prodhimeve serbe", thuhej në dokumentin e BIA-s.

Ky fakt i ka mjaftuar që shërbimi sekret serb të identifikojë prodhuesit kosovarë që po ia merrnin tregun prodhuesve serbe dhe fill pas kësaj kishte filluar përgatitja e strategjisë së dëmtimit në formë të ndryshme të këtyre prodhuesve. Në këtë strategji ishin përpunuar të dhënat me detaje për të gjitha kompanitë kosovare, potenciali i tyre, pikat e dobëta, dhe aksionet/hartat të cilat operativët e BIA-s në terren kishin ndërmarrë ndaj atyre dhe prodhimet e tyre. Në listën e gjatë të BIA figuronin kompanitë më të fuqishme të Kosovës, të cilat duhej të zëvendësoheshin me kompanitë serbe, në mënyrë që ekonomia e këtij vendi të mos bankrotonte. Ndër to përmendej Fluidi (Gjilan) me prodhimin e "Jaffa-s", cili duhej të zëvendësohej me kompaninë serbe "Nektar", pastaj Pestova (Vushtrri) me prodhimin e "Vipa Çips", që duhej të zëvendësohej me produktin serb "Çips", Fruteks (Suharekë) me prodhimin e "Golden Eagle", që duhej të zëvendësohej me produktin serb "Guarana", M Silosi (Rahovec) me prodhimin e miellit "Finesa", si zëvendësim për "Fidelinka", Kllokoti (Kllokot) me prodhimin e "Ujit Kllokoti", si zëvendësim për "Heba", Liri (Prizren) me prodhimin e "Sempre" si zëvendësim për "Plazma Keks", "Eurofood" (Prizren) me prodhimin e "Tomato Keçap" si zëvendësim për "Diamant Keçap", qumështi Vita (Istog) me prodhimin e "Vita" si zëvendësim për "Moja Kravica", "Gllareva" (Gllarevë) me prodhimin e "Spec i kuq Dukagjini", si zëvendësim për "Aleva", "ASK Foods" (Gjilan) me prodhimin e "ASK marmelata", si zëvendësim për "Pionir Mermelada", "Stone Castle" (Rahovec) me prodhimin e "Stone Castle", si zëvendësim për "Navip". Pas evidentimit të prodhimeve kosovare që do të zëvendësoheshin me ato serbe, BIA në dokumentin e saj rekomandonte që të vazhdohet me fazën e dytë të misionit, që nënkuptonte angazhimin e operativëve të BIA-s nga terreni, të cilët janë të pranishëm në institucione të ndryshme, agjenci, media e deri në parlament, ku do të përfshiheshin elemente që mund të kenë ndikim të madh në ndryshimin e situatës.


Kjo strategji serbe ka bërë që Kosova, ndonëse nuk njihet si e pavarur nga Serbia, megjithatë të mbetet 'parajsë' për ndërmarrjet e caktuara serbe, qoftë në zvogëlimin e obligimeve tatimore, qoftë në ikjen e tërësishme të tatimeve.

Një fenomen tjetër që bën pjesë gjithashtu në strategjinë e Serbisë për të dëmtuar ekonominë e Kosovës është çështja ndërmarrjeve, të cilat mundësinë e bartjes së selive në adresat në Kosovë po e keqpërdorin në mënyra të ndryshme të mashtrimeve. Për këtë qëllim, ndërmarrjet shpërngulen edhe në veri të Kosovës, që është i banuar me shumicë serbe dhe i cili që nga nënshkrimi i marrëveshjes së Brukselit, gjendet në një periudhë tranzicioni të integritimit në sistemin e Kosovës.

Strategjia e Serbisë për shkatërrimin e ekonomisë së Kosovës, nuk paraqet kurrfarë prioriteti për autoritetet shqiptare në Prishtinë. Hë për hë vetëm dyfishimi i rrogave të kabinetit qeveritar mund të quhet strategji e këtyre autoriteteve! Serbinë e largoi NATO nga Kosova, kurse politikanët e papërgjegjshëm të Prishtinës po e kthejnë atë, duke e faktorizuar ekonomikisht në një treg të vogël ku produktet serbe llogariten si të ishin vendore.

PARTY PEOPLE

"Shqiptarët festojnë kur mbarojnë zgjedhjet në Amerikë, Turqi, Gjermani, Itali e ku e di se ku. Festojnë kur fiton filan ekipi kombëtar, festojnë kur humb fistek ekipi tjetër. Festojnë festa kombëtare të kombeve të tjera, festojnë dhe ditën e Evropës prej së cilës shihen vëngër. Party people. Po t'ua kritikosh zellin me të cilin festojnë festën e tjetërkujt, ofendohen rëndë, ankohen se po i prek në identitet. Festa e fitorja sportive, elektorale a luftarake e tjetrit, me garniturë fishekzjarrësh vendore, qenkan identiteti i tyre. Festojnë, por vazhdimisht këngën ua këndon tjetërkujt", shkruan në profilin e tij, aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Arbër Zaimi.



RINIA DHE KOHA E JUGOSLLAVISË

"Pse u deshën 28 vjet! Rezultati po më del pas një analize.

Cili është rezultati. qenka prit një pjesë e madhe e atyre të Jugosllavisë të vdesin. Një gjeneratë deri në 40 vjet të bëhet e cila nuk e dinë atë kohë.



Pastaj shumë lehtë. Po si?

Këta të rinjtë nuk e dinë se edhe në kohën e Jugosllavisë në Beograd kishte nënkryetarë shteti. Biles një mandat kryetari i shtetit ishte shqiptar, i shtetit me 22 milionë banorë. Këta të rinjtë nuk e din se edhe kryeministri apo kryetari i Këshillit ekzekutiv (ashtu quhej në atë kohë) ishte shqiptar. Këta të rinjtë nuk e dinë se edhe flamuri shqiptarë ishte zyrtarë nëpër institucione shtetërore. Këta të rinjtë nuk e dinë se edhe gjuha shqipe ishte zyrtare.

Duke mos i ditur këto gjëra, po mendojnë se është bërë e arritur e madhe tash. Duhet bërë me dije rinisë se me gjithë këto nivele që kanë qenë për shqiptarët, prapë nga viti 1985 filluan presione dhe për 5 vjet na i morën të gjitha. Në vitin 1990 s'kishim asgjë. Tani gjithë kjo rrahje gjoksi se çka kemi arritur pas 28 viteve veprimtari... Aq të dobëta i kemi këto pozicione sa që të gjithë përfaqësuesit tanë vet e pranojnë se vetëm përmes ndërkombëtarëve, diçka mundemi me bërë. Sytë çelë ose aplaudim verbal", shkruan në profilin e tij në FB, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

FRIKA PERSONALE E THAÇIT

"Jo, Kosova nuk rrezikon të bëhet as Palestinë e as Qipro. Jo, Kosova nuk ka nevojë të marrë pjesë në një proces negociator pa e ndërtuar konsensusin politik, në mbrojtje të interesit të vet shtetëror. Dhe ndonëse nuk duhet ta zvarrisë këtë ndërtim të një veprimi të përbashkët politik, nuk ekzistojnë afatet as për këtë muaj e vit, as për ndonjë muaj a vit tjetër; marrëveshja me Serbinë varet prej cilësisë së saj, jo prej shpejtësisë në të arritur. Nuk bëhet garë për marrëveshje të shpejtë, por për marrëveshje të mirë. Dhe, jo, kjo marrëveshje, nëse do të jetë e mirë, nuk mund të jetë 'aksham pazarit' i Hashim Thaçit, të cilin duhet ta paguajnë gjeneratat e ardhshme me para, mund e gjak", shkruan në statusin e tij në Facebook, publicisti Veton Surroi.



MEDIACitate

Zëvendëskryeministri serb, Rasim Ljajiq është shprehur kundër konfliktit të ngrirë me Kosovën. Për të konfliktit i ngrirë nuk është një zgjidhje dhe ky problem nuk përfundon duke u lutur por duhet punë. "Është lehtë të flasësh për një konflikt të ngrirë duke mos bërë asgjë mirëpo a mund të durojnë serbët e Kosovës? Edhe me Trump, politika e Amerikës ndaj Serbisë nuk ka ndryshuar. BE edhe pse e dobësuar e ka të njëjtin qëndrim ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës", ka theksuar Ljajiq. Zëvendëskryeministri serb ka shtuar se nëse lejohet anëtarësimi i Kosovës në OKB atëherë nuk ka më për çfarë të diskutohet. "Çështja e Kosovës nuk mund të zgjidhet aq shpejt sa disa njerëz në bashkësinë ndërkombëtare e presin. Për Kosovën është duke u folur intensivisht për dekada, s'mund të zgjidhet për disa muaj, madje pozicionet janë ende shumë të largëta", ka thënë ai.

(Blic.rs, 9 korrik)

Iniciativa e presidentit Hashim Thaçi për të krijuar një grup të unitetit në procesin e dialogut me Serbinë s'po përkrahet asses nga opozita kosovare. Në këtë rrugë të vështirë politike i pari i shtetit, si kryenegociator i këtyre bisedimeve, po synon mbështetjen e partisë më të madhe opozitare (LDK). Ndonëse presidenti i Kosovës Hashim Thaçi tashmë ka paralajmëruar krijimin e një grupi të unitetit rreth procesit të dialogut me Serbinë, një gjë e tillë nuk pritet të ndodhë. Përkundrazi, partitë opozitare po vazhdojnë të mos e mbështesin mënyrën sesi ka nisur faza finale e dialogut e as udhëheqësin e kësaj etape, presidentin Hashim Thaçi. Megjithatë, nga ana e koalicionit qeverisës tashmë kanë nisur përpjekjet për ta bindur të paktën LDK-në për ta mbështetur këtë fazë ashtu si ka nisur.

(Zëri.info, 9 korrik)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUR EKAMARRË PAMJEN ESOTME BERATI?

Berati mori pamjen e sotme në shekullin XVIII dhe sidomos në shekullin XIX, pas tërmetit të vitit 1851. Në fund të viteve 30 të shekullit XIX Berati kishte 8000 banorë dhe ishin shfaqur punishtet e tipit të manufakturave. Asokohe Berati zinte vendin e dytë pas Shkodrës për fuqinë ekonomike të tregtarëve të mëdhenj, të cilët kishin agjenci në Durrës e Vlorë si edhe në Trieste, Korfuz e Maltë. Në fund të viteve 1800 në qytet kishte 820 punishte zejtare e dyqane, duke qenë kështu qendra më e lulëzuar ekonomike, tregtare e kulturore e Shqipërisë së Jugut. Deri në mes të shekullit XX në Berat

ekzistonin ende tre tregje të gjerë të cilët funksiononin rregullisht çdo të shtunë: Pazari i misrit, Pazari i bulmetit dhe Pazari i gjësë së gjallë. Ekzistonte edhe tregu i ri, me 100 dyqane moderne ku përfaqësoheshin të gjitha llojet e tregtive. Për nga numri i zejtarëve Berati ishte në vend të parë; ushtroheshin rreth 23 lloj zeje. Çdo zeje sistemohej në një rrugë të cilës i jepte emrin. Kështu shpjegohen edhe emrat e rrugëve deri në gjysmën e dytë të shekullit XX si rruga e kazanxhinjve, bakërshinjeve, xhokaxhinjve, leshpunuesve, rrobaqepësve, samarshinjeve, etj.

SOT DITË HISTORIKË PËR MAQEDONINË

NË NATO VETËM SI MAQEDONI E VERIUT

Në deklaratën e përbashkët nga të gjitha vendet anëtare, pritet të përgëzohet Qeveria e Zoran Zaevit për marrëveshje me emrin me Greqinë ndërkaq realizimi i Marrëveshjes do të përmendet në deklaratë si kusht për anëtarësim të plotë në NATO-s



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 10 korrik - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, një ditë përpara fillimit të Samitit të NATO-s, paralajmëroi se është arritur pajtueshmëri që Shkupi t'i fillojë bisedimet për anëtarësimin në NATO. "Pas marrëveshjes historike për çështjen e emrit, jemi pajtuar që ta ftojme Shkupin që t'i fillojë bisedimet hyrëse. Atëherë kur Marrëveshja do të finalizohet dhe do të implementohet do të jemi në mundësi që ta ftojme IRJM-në që të bëhet anëtare e 30-të e NATO-s me emrin e ri Republika e Maqedonisë së Veriut", tha Jens Stoltenberg.

Kur jemi tek Samiti, sot (e mërkurë), delegacioni qeveritar në krye me Zoran Zaev do merr pjesë në punimet e tij me ç'rast shefi i NATOS Jens Stoltenberg do të ftojë Maqedoninë që të nisë bisedimet për anëtarësim në NATO. Në deklaratën e përbashkët nga të gjitha vendet anëtare, pritet të përgëzohet Qeveria e Zoran Zaevit për

marrëveshje me emrin me Greqinë ndërkaq realizimi i Marrëveshjes do të përmendet në deklaratë si kusht për anëtarësim të plotë në NATO-s.

Është indikative se në punimet e Samitit të NATO-s, nuk do të jetë i ftuar Presidenti i vendit Gjorge Ivanov. Në arsyetimin e Qeverisë thuhet se Presidenti Ivanov nuk është pjesë e delegacionit dhe se ftesat i dërgon NATO duke përjashtuar përgjegjësinë e Qeverisë në këtë rast. Ndryshe ministrja e Mbrojtjes Radmilla Sheqerinska përmes një video-deklarate iu drejtua qytetarëve të Maqedonisë duke vë theksin tek pesha e madhe politike që do ti jepet Maqedonisë në momentin kur kryeministri Zoran Zaev do të ulet në një tavolinë me liderët e shteteve më të fuqishme në botë. Sheqerinska potencoi se prej vitit 2008 qytetarët kanë parë se si jetohej në një shtet të pasigurt dhe jostabil.

"Nesër dhe pasnesër, në Bruksel, Republika e Maqedonisë do të ulet në tryezë të njëjtë me superfu-

qitë botërore. Vendi ynë zyrtarisht do ta marrë ftesën për anëtarësim në NATO. E lëshuam këtë mundësi në vitin 2008 dhe prej atëherë, gjërat shkruan në drejtim të gabuar. Pamë çka do të thotë të jetohej në shtet të pasigurt dhe në rajon jostabil. Kaluam nëpër shumë kriza, ndërsa shteti stagnonte në çdo fushë. Bashkëqytetarë të respektuar, gjatë dhjetë viteve një gjë u bë e qartë – pa perspektiva të hapura për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian, e ardhmja e Maqedonisë është e pasigurt. Anëtarësimi në NATO është mundësi historike të cilën tani duhet ta shfrytëzojmë. Me këtë, Republika e Maqedonisë do të bëhet partnere dhe aleate me vendet më të fuqishme në botë. Anëtarësimi në NATO do të jetë stabilitet dhe siguri për Republikën e Maqedonisë dhe qytetarët e saj. Por, kjo do të sjellë edhe mundësi për zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe prosperitet", thotë Sheqerinska në video porosinë. Ajo thekson se vitin e kaluar u

bënë ndryshime të mëdha, hapa të mëdhenj përpara, ndërsa u zgjidhën probleme të vështira.

"Treguam se Maqedonia mundet më mirë. Jam krenare me arritjet, vazhdojmë më tutje", thotë ministrja Sheqerinska në video porosinë e saj. Edhe agjencia e njohur e lajmeve Franc Pres të martën ka shkruar se Aleanca Veri-atlantike do ta ftojë Maqedoninë që të bëhet anëtarja e 30-të.

"Edhe përkaj konfliktit rreth buxhetit për mbrojtje, shefat e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të NATO-s, do të ndajnë ftesë për anëtarësim të Maqedonisë. Atë e ka mundësuar kompromisi për çështjen e emrit me Greqinë. Megjithatë, paraprakisht duhet që të implementohet tërësisht Marrëveshja. Parlamenti në Maqedoni tanimë e ka miratuar, por mungon edhe referendumi për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë. Ai do të mbahet në shtator ose rreth tetorit. Pas kësaj do të jepet dritë jeshile nga Parlamenti i Greqisë", shkruan Frans Presi.

Gjatë Samitit të BE-së për Ballkanin Perëndimor në Londër përfaqësuesit e Grupit të Ohrit, si miq dhe mbështetës të vendit tonë në krye me ish sekretarin e përgjithshëm të NATOS Xhorxh Robertson thanë se përparimi i Maqedonisë nuk do të ishte i mundur nëse nuk do të ishte lidhshipi i guximshëm dhe realizimi i suksesshëm i reformave. Siç kumtuam nga shërbimi qeveritar për shtyp, ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Lordi Robertson, në takim informoi se të gjithë anëtarët e grupit Ohri dhe miqtë e Maqedonisë e kanë mbështetur letren e cila në emër të grupit u është dërguar shefave të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të BE-së dhe të NATO-s, për vendimin pozitiv të Këshillit të Evropës dhe për aktivizimin e paralajmëruar të ftesës për anëtarësim në NATO. Gjatë takimeve, diplomatët dhe politikanët me përvojë, përfaqësues të disa organizatave ndërkombëtare, e cekën përparimin e jashtëzakonshëm të Maqedonisë dhe e theksuan rëndësinë historike për marrëveshjen e arritur me Greqinë e cila i hapi dyert për anëtarësim në NATO dhe datën për negociatën me BE-në.

Kryeministri Zaev i ka njoftuar anëtarët e Grupit të Ohrit me hapat që paraprijnë gjatë implementimit të marrëveshjes, ndërkaq posaçërisht për referendumin në të cilin qytetarët duhet ta thonë fjalën e fundit dhe zgjedhjen për të ardhmen e vendit që e garanton anëtarësimin në NATO dhe fillimi i negociatave me Bashkimin Evropian. Bashkëbiseduesit në takimet e punës u dakorduan se është me rëndësi tejet të madhe që shumica e qytetarëve e mbështesin anëtarësimin në BE dhe në NATO dhe se ky është argument për pritje optimiste për epilogun e referendumit.

Britania rrit fondet për Ballkanin Perëndimor



Londër, 10 korrik - Britania tha se gati do të dyfishojë fondet për Ballkanin Perëndimor, për t'iu ndihmuar vendeve të këtij rajoni që të trajtojnë kërcënimet e përparimit të tyre,

sidomos në luftën kundër krimit të organizuar dhe kontrabandës me drogë. Kryeministrja britanike, Theresa May, i bëri këto komente në Londër, ku sot mbahet Samiti i Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim marrin pjesë udhëheqës të gjashtë vendeve të këtij rajoni, ashtu si edhe figura evropiane jashtë tij, përfshirë kancelaren gjermane, Angela Merkel, dhe kryeministrin polak, Mateusz Morawiecki. Ballkani Perëndimor përbëhet nga Shqipëria, Bosnja, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Tubimi është samiti i pestë në kuadër të Procesit të Berlinit, i krijuar në vitin 2014, me qëllim thellimin e lidhjeve midis Ballkanit Perëndimor dhe shteteve anëtare të BE-së.

Publicitet

KONKURS

Gazeta KOHA shpallë konkurs për:

- dy redaktorë (me përvojë pune)
- katër gazetarë (me përvojë pune)

Kushtet: Kandidatët të kenë të mbaruar arsimin sipëror, si dhe përvojë në redaktim dhe në raportim nga terreni. Përparësi do të kenë kandidatët, të cilët, përpos gjuhës shqipe, zotërojnë edhe ndonjë gjuhë tjetër.

Të interesuarit duhet që CV-të e tyre t'i dërgojnë në e-mail adresën: marketing@koha.com.mk.

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjat deri të mërkurën (11 korrik).

VMRO të mbështesë anëtarët e KSHZ-së, amnisti nuk ka

Shkup, 10 korrik - VMRO-DPMNE duhet të tregojë përgjegjësi dhe të ndalon së bllokuar reformat, duke tentuar ta pengon përparimin e Maqedonisë drejt anëtarësimit në BE dhe NATO. Kodi zgjedhor dhe Ligji për financimin e partive politike më herët janë dakorduar dhe jemi të gatshëm menjëherë t'i mbështesim në Parlament. Kështu thuhet në thirrjen e LSDM-së, duke i apeluar VMRO-së t'i pranojë tekstat e ligjeve, të cilat tashmë janë shkruar. "Të gjithë duhet ta kenë të qartë se amnisti për krim nuk do të ketë. Presim që VMRO-DPMNE ta thërrasë Komisionin për zgjedhje dhe emërimet që të zgjedhen anëtarët e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve. Sepse ky është parakusht për mbajtjen e referendumit për të ardhmen e shtetit. Maqedonia ec përpara si shtet modern, demokrat, në miqësi me të gjithë botën dhe anëtare e BE-së dhe NATO-s. Asnjë tentim i forcave destruktive nuk do ta kthen shtetin në kohën e izolimeve, ndarjeve dhe paqartësive, qytetarët do të thonë PO për të ardhmen e Maqedonisë", thuhet në apelin e LSDM-së.

Shtantazhohet 20-vjeçarja, përdhunohet nga 46-vjeçari

Shkup, 10 korrik - Një vajzë 20 vjeçare nga Koçani është shantazhuar dhe detyruar në marrëdhënie seksuale nga ana e një burri 46-vjeçar. Sipas deklaratës së saj, në periudhën nga nëntori i vitit të kaluar deri në momentin e paraqitjes së rastit në disa kthime është shantazhuar nga ana e 46 vjeçarit M.L. nga Koçani se për të publikisht do të tregojë fotografi me përmbajtje të komprometuar dhe është detyruar në marrëdhënie seksuale. Rastin e ka paraqitur dje në orën 20:30 në stacionin policor në Koçan. Ndërmerren masa për zbardhjen e rastit. (mia)

"Në gjithsej 13 sektorët, tetë i kushtohen historisë së organizatës VMRO duke e vënë muzeun në shërbim të një ideologjie dhe mitizimit të saj. Ne kemi sugjeruar që të hiqet skenografia, të reduktohet figurat në dyllë që janë 150 të tilla, pasi nuk është teatër, por muze, i cili duhet të tregojë historinë e suksesit të një populli të vogël që lufton për pavarësinë e vet", ka thënë historiani Aleksandar Litovski, anëtar i Grupit të punës

Koha

Evis HALILI

Shkup, 10 korrik - Epokës së figurave prej dylli dhe silikoni në muzetë nacionale po i afrohet fundi. Me Strategjinë katërvjeçare për zhvillimin e kulturës parashikohet ngritja e grupeve të punës që do të merren me këtë çështje dhe spastrimin e koleksioneve të muzeve nga pjesët e panevojshme, si butaforitë, figurat në dyll, silikon, pikturat ilustrative, e të tjera.

Pas Muzeut të VMRO-së, radhën e kanë të gjitha institucionet e tjera nacionale ku improvizimet e bëra gjatë viteve të fundit të fragmenteve historike do të zëvendësohen me materiale origjinale. Muzeu i Luftës Maqedonase për Shtetësi dhe Pavarësi (Muzeu i VMRO-së) dhe Muzeu i viktimave të regjimit komunist janë ndër objektet e para në të cilat grupi i punës i ngritur nga ish-ministri i Kulturës, Robert Allagjovovski është duke sh-

GRUPI I PUNËS GATI ME RAPORT



FUND PËR DYLLIN DHE SILIKONIN TE MUZEU I VMRO-së

qyrtuar jo vetëm parregullsitë në themelimin e tyre dhe abuzimet financiare, por edhe pjesën e koleksioneve të tyre.

Donka Barçeva Trajkovska, anëtare e këtij grupi pohon se figurat prej dylli dhe silikoni që viteve të fundit janë bërë pjesë e shumë muzeve përbëjnë një paradoks për institucionet serioze. Për shkak se figurat e tilla që vendosen me qëllim ilustrativ janë tipike të muzeve private, komerciale, por assesi atyre nacional. "Muzeologjia është shkencë dhe si e tillë - koleksioni i një muzeu duhet të përbëhet nga dokumente origjinale, ose edhe në rastet kur kemi material të tillë ilustrues, ai nuk duhet të jetë dominant, apo në rastin më të keq - me efekte audiovizuale. Në një pjesë të muzeve tek ne historianët janë futur në pjesën ku

mbaron shkenca dhe fillon improvizimi. Për shembull, kanë përcaktuar se një figurë duhet të jetë 1.80 metra i gjatë, të peshojë 90 kilogramë, të ketë sy kafe apo bojëqielli, të jetë i veshur me kostum, apo roba fshati... Kjo është absurde", ka thënë Barçeva Trajkovska gjatë prezantimit të Raportit për muzeun e luftës maqedonase VMRO dhe të viktimave të komunizmit.

Grupi i punës ka propozuar jo vetëm që të shkurtohet emri i muzeut, duke u thjeshtuar në "Muzeu i Luftës Maqedonase", por edhe të vetë përmbajtjes, materialit dhe mënyrës së prezantimit të historisë. Për këtë projekt të Qeverisë që ka nisur në vitin 2006, Grupi i punës ka konstatuar një sërë abuzimesh, shkelje flagrante të Ligjit për veprimtarinë muzeale, për

mbrojtjen e trashëgimisë, si dhe shkelje të principet dhe standardet bazë të muzeologjisë bashkëkohore.

"Në gjithsej 13 sektorët, tetë i kushtohen historisë së organizatës VMRO duke e vënë muzeun në shërbim të një ideologjie dhe mitizimit të saj. Ne kemi sugjeruar që të hiqet skenografia, të reduktohet figurat në dyllë që janë 150 të tilla, pasi nuk është teatër, por muze, i cili duhet të tregojë historinë e suksesit të një populli të vogël që lufton për pavarësinë e vet", ka thënë historiani Aleksandar Litovski, anëtar i Grupit të punës.

Për realizimin e këtij projekti, pas 16 milionë denarë të ndara në vitin 2006 për fillimin e punimeve, deri në përfundim janë harxhuar gjithsej rreth 17 milionë euro.

Vit i planifikimit të familjes si e drejtë e njeriut

Shkup, 10 korrik - Edhe pse kaluan vite pasi kontracepsioni modern erdhi në botë, akoma ekzistojnë vajza dhe gra të cilat nuk kanë qasje tek ai, konstatoi përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Luiza Vinton në shënimin e djeshëm të Ditës Botërore të popullsisë,

kushtuar të Drejtës së Planifikimit të Familjes. Ajo theksoi se në botë rreth 225 milionë gra të cilat duan të mbrohen prej shtatzënisë nuk përdorin metoda të sigurta dhe efikase për planifikimin e familjes për arsye të ndryshme, duke filluar nga mungesa e

qasjes së informacioneve dhe shërbimeve e deri te mungesa e mbështetjes nga partneri apo bashkësia. "Serviset për planifikimin e familjes duhet të ekzistojnë në çdo shtet. Planifikimi i familjes i inkurajon njerëzit dhe i zhvillon kombet", theksoi Vinton.

"LLUPA E GJELBËR" NË SHËNJESTËR GJYQËSORIN

PËRGJEGJËSI TË JAPIN EDHE GJYKATËSIT

Shkup, 10 korrik - Na nevojiten reforma urgjente në gjyqësi dhe përgjegjësi për gjykatësit të cilët kanë gabuar para Ligjit, para institucioneve dhe qytetarëve, theksoi kryetari i shoqatës "Llupa e gjelbër", Vane Cvetanov në debatin e djeshëm me temë "Ta kthejmë besimin në gjykatat-drejtësi për të gjithë". Ai potencoi se sistemi për konfirmimin e përgjegjësive së gjykatësve është faktori më i rëndësishëm për sundimin e së drejtës dhe, siç shtoi, e hapin debatin publik para se të fillojnë negociatat me BE-në, ku presin të përf-

shihet edhe opinioni me qëllim që të përmirësohet sistemi gjyqësor në Maqedoni. "Propozojmë të hiqet amendamenti 27 nga Kushtetuta e RM-së, i cili, sipas neve është antikushtetues, pasi nga njëra anë Kushtetuta thotë se të gjithë qytetarët janë të njëjtë në këtë shtet para ligjeve, ndërsa nga ana tjetër i bën gjykatësit mbi të tjerët", tha Cvetanov. Nga "Llupa e gjelbër" paralajmëruan se do të parashtrijë iniciativë për ndryshime ligjore në pjesën e përgjegjësive së gjykatësve, si dhe për ndryshimin e afatit

të shkurtë prej tri viteve për konfirmimin e përgjegjësive së tyre. Cvetanov thotë se Ligji për Këshill gjyqësor parashikon nëse konfirmohet përgjegjësia e gjykatësit, instanca e shkallës së dytë të jetë Gjykata Supreme. Nga "Llupa e gjelbër" kërkuan ndihmë nga ekspertët, qytetarët dhe organizatat qytetare për ngritjen e përgjegjësive penale për presidentin e shtetit për abolim jologjor. "Ndihmën eksperte e kërkojmë me qëllim që të pengojmë abolim të ri për çka kemi informata se po përgatitet", tha Cvetanov. (mia)



SHKUPI ASSESI TË NORMALIZOHET

“SAZDOVI” TË MOS POLITIZOHET


Përleshjet mes të rinjve të përkatësive etnike çdoherë kanë qenë prezente në Shkup. Por, për dallim nga e kaluara, kur rastet si ky i Sazdovit janë trajtuar në aspektin etnik, sot institucionet shtetërore dhe opinionin më i gjerë bën thirrje për maturi dhe gjakftohtësi

Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 10 shkurt - Vdekja e të riut nga Shkupi, Nikolla Sazdov, të mos politizohet. Ngjarjet tragjike si pasojë e zënkave mes të rinjve, si në rastin e fundit - janë prezente në çdo shoqëri. Fakti se kryeqendra e Maqedonisë është e përbërë nga etni të ndryshme, ku dominojnë shqiptarët dhe maqedonasit, nuk e arsyeton qëndrimin se vdekja Sazdovit duhet të trajtohet si rast etnik. Këtë mendim e ndajnë shumica e qytetarëve dhe opinionistëve, të cilët e dënojnë shkallën e lartë të mos durimit mes të rinjve. Edhe apeli i organeve të rendit dhe institucioneve përkatëse është që më këtë rast të merren organet e drejtësisë dhe jo qytetarët. Reagimet dhe revolta e madhe, sidomos te pala maqedonase për vdekjen e të riut maqedonas, Ministria për Punë të Brendshme ka tentuar ta relativizojë, me çka qëndrimi i këtij dikasteri të Qeverisë është që rastit të Sazdovit mos ti jepet karakter etnik. Arrestimi në kohë i dy prej tre personave dyshuar për rrahjen brutale të Sazdovit (B.B, 20 dhe S.D 21 vjeçar) dhe shqiptimi i masës së paraburgimit 30 ditor ndaj tyre, sipas MPB-së, paraqesin indikator të mjaftueshëm se policia ka ndërmarrë masa urgjente për zbardhjen e rastit.

Mbase organet e rendit i kanë siguruar të dhënat për fajtorët e mundshëm të rrahjes së Sazdovit, i cili pas një qëndrimi dhjetë ditor në gjendje kome, ndërroi jetë, hetimet e mëtutjeshme për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje pritet ti vazhdojë Prokuroria e Shkupit. Pas përfundimit të



obduksionit mbi trupin e të ndjerit dhe pas marrjes së dëshmisë kyçe e cila mendohet të jepet nga e dashura e Sazdovit, e cila e ka shoqëruar në çastet kur është sulmuar, Prokuroria Publike duhet të dalë me vendimin përfundimtar se të dyshuarit do të ngarkohen për “dhunë me pasojë vdekje” apo për veprën penale “vrasje”.

Në rastin e parë, Kodi Penal i Maqedonisë parasheh që dënimi për veprën penale “dhunë me pasojë vdekje” të shkojë nga 3 deri në 10 vite burg, përderisa për veprën penale “vrasje” - nga 5 deri në 20 vite burg.

Paralelisht me përgatitjen e akuzës kundër sulmuesve të Sazdovit, Prokuroria e Shkupit duhet të hetoj rastin edhe në drejtim të çështjes se vallë, sulmuesit që në këtë rast janë shqiptarë, kanë pasur ndonjë zënkë personale me Sazdovin apo përleshja mes tyre ka ndodhur pikërisht për shkaqe të rivalitetit mes tifozërive, në këtë rast “Komitëve” dhe “Shvercerave”. Qëndrim zyrtar i këtyre të fundit është se nuk kanë asnjë lidhje me ngjarjen, për shkak se tash është kohë e pushimeve dhe klubi i tyre ditën e ngjarjes nuk ka pasur asnjë aktiviste. Nga ana tjetër, “Komitet”

publikisht e kanë pranuar se Nikolla Sazdov ka qenë anëtar i tyre dhe se për të njëjtin do të hakmerren.

Mbas periudha që vijon është kohë kur klubet vendase i fillojnë garat kualifikuese për në Ligën e Kampionëve dhe Ligën Europa, MPB-ja përmes një kumtese zyrtare ka bërë thirrje që grupet e tifozëve ti përmbahet kodeksit të animet korrekt dhe të drejtë, duke i mbështetur ekipet e tyre drejt suksesit. Njëkohësisht, nga kjo ministri kanë theksuar se aspak nuk do të tolerojnë incidentin më të vogël, i cili do të nxisë dhunë dhe prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Ndryshe, një rast i ngjashëm i cili sipas shumë qytetarëve mbetet ende i paqartësuar deri në fund, mbetet vrasje e Angel Petkovskit në vitin 2014 nga i riu Naser Eshtrefi. Ngjarja e ndodhura në lagjen Gjorçe Petrovë atë kohë rezultoi me trazira të mëdha, të cilët përkundër arrestimit të Eshtrefit, nuk u ndalën, por vazhduan me djegien e pronave të shqiptarëve në këtë pjesë të Shkupit. Megjithatë, edhe pse dëmi kundër shqiptarëve llogaritet me qindra mija euro, huliganët maqedonas asnjëherë nuk u zbuluan.

KRONIKË**19-vjeçarja merret me forcë nga ish i dashuri**

19 vjeçarja R.O nga fshati Pallaticë ka denoncuar se dje rreth orës 18 e 30 minuta, derisa ka qenë duke shkuar tek shoqja e saj, në afërsi të shkollës së fshatit është ndaluar vetura e tipit “Pollo” e drejtuar nga personi N.K. 19 vjeçar nga fshati Poroj, me të cilin janë njohur një kohë më të gjatë dhe të cilit ka patur për qëllim ti kthejë dhuratat e mëhershme. Sipas sqarimit të saj, kur është i afëruar veturës, N.K. me forcë duke e tërhequr për flokë, e ka futur në veturë, pastaj e ka rrahur duke u kërcënuar se edhe në të ardhmen është e detyruar të jenë bashkë. Në një moment ajo ka arritur të dalë nga vetura, e cila ka lëvizur në rrugën rajonale Shkup-Tetovë, dhe me veturë të një kalimtarit të rastit, është kthyer deri në fshatin Zhelinë. Më vonë, N.K. është vetëparaqitur në stacionin policor në Grupçin, për tu sqaruar lidhur me rastin. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Vjedhje e rëndë në Tetovë

44 vjeçari me iniciale B.C. nga Tetova ka denoncuar vjedhje të rëndë në banesën e tij në rrugën e “Ilindenit” në Tetovë. Në periudhën në mes datës 2 deri dhe 9 korrik, derisa në banesë nuk ka qenë askush, persona të panjohur, me çelës të përshtatshëm e kanë hapur derën hyrëse prej metali, kanë hulumtuar nëpër gjithë brendësinë e banesës dhe nga një kuti zbkuruese në dhomën e fjetjes, kanë marrë disa pjesë të llojllojshme stolie prej ari. Me stolitë e vjedhura, të pa vërejtur nga askush, e kanë lëshuar banesën, ku në mënyrë të paligjshme, kanë përvetësuar përfitime pronësore, me vlerë prej 276 mijë denarë. Janë kryer hetimet dhe merren të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit dhe zbulimin e kryerësve të vjedhjes.

Aksident në Tetovë, tre të lënduar

Në rrugën e “Jashtëvardarit” në Tetovë, dje rreth orës 21.00, vetura e tipit “Jugo” me targa të Gostivarit, e drejtuar nga 50-vjeçari A.D. nga Gostivari, ka humbur kontrollin, ka dalur nga rruga dhe është përplasur në një shtyllë prej betoni. Pas këtij aksidenti, bashkudhëtarët në veturë Q.D. 51-vjeçare, Z.R. 37-vjeçare dhe R.R. 40 vjeçarë - të gjithë nga Gostivari, me veturë tjetër janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës, ku janë mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm. Punohet në zbardhjen e shkakut të daljes të veturës nga rruga, rrethanat dhe të gjitha detajet lidhur me aksidentin. (U.H)

Për gjashtë muaj, katër viktimat në aksidente trafiku

Tetovë, 10 korrik - Katër viktimat, 21 të lënduar rëndë dhe 372 persona të lënduar lehtë, është bilanci gjashtëmuajor i 397 aksidentëve në trafik, të cilat në këtë periudhë kanë ndodhur në rajonin më të gjerë të Tetovës. Në këto aksidente janë shkakuar edhe dëme materiale që llogariten rreth 18 milionë denarë. Nga viktimat në këto aksidente, tre prej tyre janë bashkudhëtarë dhe një motoçiklist. Në mesin e personave të lënduar rëndë, gjithashtu më të shumtë janë bashkudhë-

tarët edhe atë 205 të lënduar, vozitës janë 114 të lënduar, ndërsa numri i këmbësorëve me lëndime të rënda trupore arrin në 37 të lënduar.

Numri më i lartë i pjesëmarrësve në aksidente trafiku, në gjashtë muajorin e parë janë meshkuj edhe atë 616 persona, shumica të moshës mbi 18-vjeçe, kurse janë të regjistruar edhe 14 persona të mitur mes të cilëve kemi edhe fëmijë. Në periudhën për të cilën bëhet fjalë, 10 biçiklistë kanë qenë pjesëmarrës direkt në

aksidente trafiku si dhe tetë traktoristë, gjithashtu dhe 38 persona të cilët kanë drejtuar automjete të rënda kryesisht kamion me rimorkio dhe kombi. Pjesa më e madhe e aksidentëve kanë ndodhur në lëvizje, edhe atë 220 aksidente, vendet ku kanë ndodhur janë kryesisht vendbanimet, para së gjithash nëpër rrugët e qytetit në pjesën qendrore të Tetovës, dhe më vijim pasojnë në rrugët rrethore rajonale, si dhe në autostradën Gostivar-Tetovë-Shkup. (U.H)

Mbi një milion udhëtarë me TAV Maqedoni

Shkup, 10 korrik - Nëpërmjet Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit dhe Aeroportit të Ohrit "Shën Apostol Pali", në gjashtë muajt e parë të vitit, janë transportuar 1.041.583 udhëtarë, që paraqet rritje vjetore prej 21 për qind, në krahasim me gjysmën e parë të vitit të kaluar, njoftoi TAV Maqedoni, koncesionar i aeroportëve në Shkup dhe në Ohër. Në periudhën e njëjtë, nga janari deri në qershor të këtij viti numri i fluturimeve në të dy aeroportet e Maqedonisë ka arritur 9.033, me rritje vjetore prej 16 për qind. "Përderisa aeroportet evropiane kanë rritje mesatare në numrin e udhëtarëve prej 6,1 për qind në vitin 2018, TAV vazhdon të shënojë norma të larta dyshifrore në qarkullimin e pasagjerëve në aeroportet e Maqedonisë. Ky trend pozitiv në rritjen e qarkullimit ajror, e konfirmon potencialin e madh të cilin e ka tregu i aviacionit në Maqedoni. Do të vazhdojmë të bëjmë përpjekje maksimale për zhvillimin e aeroportëve në Shkup dhe në Ohër, me tërheqjen e linjave të reja ajrore dhe zgjerimin e rrjetit të destinacioneve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet kompetente shtetërore", deklaroi Alper Ersoj, drejtor i përgjithshëm i TAV Maqedoni. Siç potencojnë nga kompania, rritja e qarkullimit të udhëtarëve me 21 për qind, që TAV Maqedoni e regjistroi nga janari deri në qershor të këtij viti, e tejkalon edhe rritjen mesatare të aeroportëve të vendeve të cilat nuk janë anëtare të BE-së, e cila është 12,5 për qind në pjesën e parë të vitit 2018. Destinaconet më të shpeshta sipas qarkullimit të udhëtarëve në gjashtë muajt e parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit janë: Stambolli, Cyrihu, Bazeli, Vjena, Malme dhe Bratisllava.

EUFORIA E LOJËRAVE TË FATIT ASSESI TË NDALET

MË SHUMË PARA HARXHOHEN NË BASTORE SE SA PËR BUKË

Totali i të hollave që qytetarët kanë harxhuar për të luajtur baste në zinxhirin më të madh të bastoreve në vend "Sport Lajf" prej afër 83 milionë euro është më i madh se harxhimi i 60 milionë eurove i mishit apo bukës dhe parorive të bardha për një vit

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 korrik - Qytetarët në Maqedoni harxhojnë në bastore afër 200 milionë euro, ndërsa për ushqim harxhojnë afër 600 milionë euro. Kjo i bie se lojërat e fatit i kushtojnë buxhetit familjar sa një e treta e të hollave që harxhohen për artikujt e ndryshëm ushqimor brenda një viti.

Të dhënat e Drejtorisë për të Ardhura Publike tregojnë se bizneset e bastoreve sportive vitin e kaluar kanë pasur qarkullim prej 198 milionë euro, gjegjësisht qytetarët kanë harxhuar afër 200 milionë euro me shpresë se do dalin prej problemeve financiare. Nga ana tjetër, përlogaritjet të bazuara në të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikës lidhur me qarkullimin në



tregtinë me pakicë, tregojnë se sipas prodhimeve të ndryshme si pemë-perime, mish, qumësht, bukë dhe prodhime të ndryshme të furrës, pije të ndryshme, duhan, e kështu me radhë, qytetarët kanë harxhuar afër 590 milionë euro.

Në ndërkohë, analiza e të dhënave për konsumin e llojeve të ndryshme të ushqimit tregon se qytetarët, bile më shumë harxhojnë për baste se sa harxhojnë për pemë-perime, bukë apo mish. Nëse krahasohet vetëm harxhimi i të hollave për perime si groshë, spec, domate... apo pemëve si mollë, banane, rrush... për të cilat në vit harxhohen afër 78 milionë euro, atëherë del se kjo shumë është për pesë milionë euro më e vogël se shuma që qytetarët kanë harxhuar vetëm në bastoret "Sport Lajf" për një vit.

Cjithashtu, të hollat që qyte-

tarët kanë harxhuar për të luajtur baste në zinxhirin më të madh të bastoreve në vend "Sport Lajf" prej afër 83 milionë euro është më i madh se harxhimi i 60 milionë eurove i mishit apo bukës dhe parorive të bardha për një vit. Harxhimi i madh të qytetarëve për lojërat e ndryshme të fatit shpjegohet nga ana e sociologëve si rënie e ekonomisë, por edhe orientim i kotë drejt zgjidhjes së problemeve financiare përmes vënies baste.

Nga ana tjetër, qytetarët shpresojnë se me 50 deri me mijëra denarë për pagesën e një basti, mund të fitojnë deri 600 mijë denarë dhe me këtë, të zgjedhin problemet e ndryshme ekzistenciale. Këtë e ofrojnë bastoret sportive në vend për të gjithë ato që dëshirojnë që në mënyrë të shpejtë dhe të lehtë të fitojnë ndonjë denarë. Prej Kam-

ponatit Botëror në futboll, kampionateve të tenisit si ai i Uimblidon, kualifikimeve për Ligën Evropë apo Ligën e Kampionëve, futbollit të pesë ligave më të fuqishme evropiane, por edhe të shumicës së ligave të futbollit në tërë botën, basketbollit, hendbollit, etj.

Në buletinet ekziston një përzgjedhje e madhe e sporteve të ndryshme. Ofrohen edhe llojet e ndryshme të fitimit në rast se ia qëlloni se si do të përfundojë ndonjë lojë, sa gola do të shënohen, si do të përfundojë pjesa e parë ose e dytë e kështu me radhë.

Në ndërkohë, përlogaritjet e tjera tregojnë se nëse në vit harxhohen 200 milionë euro në bastore, ndërsa Maqedonia ka dy milionë qytetarë të Maqedonisë, atëherë del se çdo qytetar në mesatare vendos nga 100 euro në bastore. Nëse e marrim parasysh se në totalin e banorëve ka mjaft edhe persona të rritur dhe gra që rrallëherë apo asnjëherë nuk mbushin ndonjë tiket basti, atëherë mund të konstatojmë se në mesatare - çdo banor i Maqedonisë në vit harxhon në bastore nga një pagë mesatare. Në ditë, në Maqedoni paguhen afër 550 mijë euro para në bastore, ndërsa mesatarja thotë se çdo banor harxhon nga 17 denarë në ditë në bastore.

Shtohet afati për privatizimin e tokës ndërtimore

Shkup, 10 korrik - Qytetarët përsëri do të mund të dorëzojnë kërkesa për privatizimin e tokës ndërtimore në pronë shtetërore në Drejtorinë për Çështje pronësore-juridike.

Në ndryshimet e Ligjit për privatizim dhe dhënies me qira të tokës ndërtimore në pronë sh-

tetërore, që hynë në fuqi dje, qytetarët përsëri kanë të drejtë për privatizim të tokës. Kërkesat për privatizim ligjërish nuk mund të dorëzoheshin nga skadimi i afatit të mëparshëm më 15 dhjetor 2014, e deri më sot. Dokumentet që duhet të dorëzohen ndaj kërkesave janë: kopje e letërnjoft-

timit apo pasaportës, bazë ligjore në bazë të së cilës është fituar e drejta e shfrytëzimit të tokës (ligj, tap, aktvendim, marrëveshje, vendim, vendimi i autoritetit kompetent) dhe të dhëna për tokën, gjegjësisht fletëpronësi nga kadastra e pasurive të patundshme apo certifikatë pronë-

sie nga kadastra për tokën. Kërkesat dorëzohen në njësitë rajonale të Drejtorisë për Çështje pronësore-juridike në komunën ku gjendet toka. Afati përfundimtar për dorëzimin e kërkesave për privatizimin e tokës ndërtimore në pronë shtetërore është 31 dhjetori i vitit 2021.

HYN NË FUQI LIGJI PËR ZVOGËLIMIN E VLERAVE TË PAGESAVE NË DORË

Çdo pagesë kesh mbi 2000 euro, do të tatimohet

Shkup, 10 korrik - Mërgimtarët, qytetarët dhe biznesmenët e Maqedonisë në të ardhmen nuk do të mund të bëjnë pagesa kesh në vlerë më të lartë se 2000 euro. Ky kufizim i pagesave në dorë është për shkak se nga 7 korriku i këtij viti, pas publikimit në gazetën zyrtare të Maqedonisë, hyri në fuqi Ligji i cili zvogëlon vlerën e pagesave në dorë dhe çdo pagesë në dorë që tejkalon shumë mbi 2000 euro, patjetër të kalojë përmes bankave apo institucioneve

tjera financiare siç janë "Western Union" apo "Money Gram". Para se të hynë në fuqi ky Ligj, lejohej që qytetarët apo biznesmenët të mund të paguanë para kesh në vlerë deri më 13.000 euro. Miratimin e këtij Ligji Qeveria e arsye ton me faktin se, me zvogëlimin e vlerës për pagesa kesh nga 13.000 euro në 2000 euro, dukshëm do të kontribuohet në parandalimin e larjes së parave apo financimin e organizatave terroriste. "Ndalohen pagesat kesh apo pranimin e pa-

gesave kesh apo këmbimin e valutatave të huaja në denarë që kapin vlerën më shumë se 2000 euro qoftë për një transaksion apo më shumë transaksione që nuk kalojnë përmes bankave apo institucioneve tjera financiare në vend", thotë Mile Boshnjakovski, zëdhënësi i Qeverisë së Maqedonisë. Gjithashtu, ai informoi se nga 1 janari i vitit të ardhshëm do të ketë përforsime plotësues të pagesave kesh. Sipas tij, zgjidhja e re ligjore sa i përket Ligjit të vjetër, i cili

lejonte pagesat kesh të mallrave apo shërbimeve në vlerë deri më 1000 euro, nga 1 janari i vitit 2019 kjo pagesë zvogëlohet në 500 euro dhe pagesa mund të kryhet vetëm në valutën e denarit. "Kjo ndalesë e pagesave kesh vlen edhe për personat fizik dhe juridik. Çdo pagesë që do të kryhet në vlerë prej 500 eurove në kundërvlerë në denarë, do të duhet patjetër të regjistrohet si qarkullim ditor që do të thotë se vlera do të tatimohet. Në drejtim të uljes së ekonomisë jofor-

male, Ligji i ri do të ndalon çdo pagesë në kesh në vlerë prej 15.000 euro në 2000 euro që në mënyrë direkt do të kontribuon në uljen e ekonomisë joformale", thotë Boshnjakovski. Përveç kufizime të pagesave kesh të personave fizik dhe juridik, Ligji ri mendohet se do të rrisë dhe kompetencat e institucioneve shtetërore përkatëse për kontrollimin e funksionarëve shtetëror që të mos munden në të ardhmen të marrin veprime jashtëligjore për larje parash. (Z.V)

Anomalia që vjen prej politikave të gabuara të çmimeve ka bërë që qytetarëve tanë më lirë iu bie të blejnë produktet të brendeve të njohura diku jashtë, se sa brenda, ndonëse fuqia blerëse këtu vazhdon të jetë shumë e dobët

NËN TRYSNINË E ÇMIMEVE JO REALE

NË EUROPË MË LIRË SE TË NE!



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 korrik - Qytetarët e Maqedonisë e paguajnë më shtrenjtë veshmbathjen e brenduar sesa banorët e Evropës. Pjesët e ndryshme të veshmbathjes verore apo edhe dimërore, rrobat e fëmijëve, atletet "Adidas" apo "Nike", blihen shumë më shtrenjtë tek ne në raport me shtetet perëndimore. Çmime të kripura kanë edhe këpucët e brendeve të ndryshme. Në dyqanet e njohura në Shkup, brendet e njohura ofrohen me çmime prej 30 deri 50 për qind më të lartë në raport me qytetet e mëdha evropiane.

Dallimin e madh në çmime e dëshmojnë edhe vizitat familjare apo turistike të qytetarëve të Maqedonisë në qytetet evropiane. Gjatë vizitës së familjarëve në Gjermani, Zvicër apo shtetet tjera

mund të vërehet se një xhaketë që këtu kushton së paku 50 euro, atje paguhet 20 euro. Pantallonat e xhinsit që këtu bile me lirim kushtojnë 20 euro, jashtë mund të blihen edhe për 10 euro. Bile dallimet e markave të ndryshme në Spanjë apo Bullgari dallojnë, bie fjala, për një mantel femrash në shitjet verore prej 39 euro tek ne, deri në 25 euro në këto dy shtete evropiane. Ekonomistë thonë se tregu i vogël që imponon edhe

qarkullimin më të dobët të mallrave dhe kapitalit, konkurrenca e ulët, por edhe kostoja e lartë e punës së tregtarëve në vend imponojnë një situatë të tillë.

"Çmimet si zakonisht imponohen në varësi prej tregut, madhësisë dhe zhvillimit të tij. Kjo nënkupton se në Berlin, apo Romë, si rrjedhojë e shitblerjeve që maten me disa mijëra ekzemplarë në javë, çmimet e mallrave janë më të ulëta, kemi qarkullim

më të shpejtë dhe mundësi që pjesët e mbetura apo të vjetra të gardërobës të ofrohen me çmime më të lira në fund të sezonit", shpjegojnë ekonomistët problemin, pse edhe konsumatorët në vend nuk mund tu gëzohen çmimeve më të ulëta të brendeve të njohura.

Nga ana tjetër, tregtarët thonë nëse si zakonisht bëjnë porosi të vetëm disa modeleve, dhe jo të një gamë të tërë të linjës prodhuese,

atëherë edhe kjo ndikon në çmimet me pakicë dhe indirekt edhe në çmimet me shumicë të shitblerjes, që detyrimisht për tregun tonë janë më të larta. Kur kësaj i shtohen edhe kostoja e transportit, doganës, kompensimeve të ndryshme ndaj shtetit, atëherë fitohet edhe çmimi final që është më i shtrenjtë në Maqedoni në krahasim me tregjet evropiane. Tregtarët thonë se përkundër tatiimeve të ulëta në vend, megjithatë çmimet e qirasë, kompensimet e ndryshme parafiskale që nuk janë direkt tatiime në fund shtrenjtojnë koston e punës së tyre.

Ndryshe, Maqedonia akoma ngec mjaft sipas fuqisë blerëse të qytetarëve të saj. Në tre vitet e fundit, apo në periudhën 2014-2016, konsumatorët në vend kanë fuqi blerëse prej vetëm 40 për qind të mesatares evropiane. Sipas dhënave të Eurostatit, apo zyres evropiane të statistikave, vetëm Shqipëria dhe Bosnje e Hercegovina me 37 për qind të mesatares evropiane lidhur me fuqinë blerëse për kokë banori renditen më dobët se Maqedonia. Bile edhe Serbia me 45 për qind, Mali zi me 52 për qind dhe Bullgaria me 51 për qind të fuqisë mesatare blerëse qëndrojnë më mirë se ne sipas nivelit personal të konsumit.

MINISTRI ADEMI PËR ANADOLU AGENCY

NJË MILIARD EURO NGA DIASPORA HYJNË NË MAQEDONI

"Segmenti ekonomik është shumë i rëndësishëm dhe në baza vjetore rreth 460-500 milionë euro hyjnë zyrtarisht. Megjithatë, jozyrtarisht, numrat arrijnë edhe deri në një miliardë", thekson Ademi



Shkup, 10 korrik - Maqedonia si shtet ka traditë të gjatë të shpërnguljes së popullsisë në vendet e ndryshme të botës, ku njerëzit migrojnë për arsye të ndryshme, por më së shumti për shkaqe ekonomike. Në shumë vende të botës jetojnë njerëz me origjinë nga Republika e Maqedonisë, të cilët lidhjet e tyre familjare, tradicionale dhe kulturore i mbajnë me vendin e tyre të origjinës.

Kështu ka thënë në një intervistë për Anadolu Agency ministri i Diasporës në Maqedoni, Edmond Ademi, sipas të cilit, nevojat më të

zakonshme të diasporës janë të natyrës administrative. Siç theksoi ministri Ademi, nuk ka të dhëna konkrete statistikore se sa të shpërngulur nga Maqedonia gjenden në vende të caktuara, ka informacione të ndryshme, por, siç thotë ai, diaspora e Maqedonisë kryesisht jeton në disa vende evropiane, duke përfshirë Gjermaninë, Zvicrën, Italinë, Austrinë dhe Suedinë, ndërsa në vendet e tjera evropiane

gjendet në numër më të vogël, kurse në kontinente të tjera, në Kanada, SHBA dhe Australi gjithashtu jeton numër i madh i personave me origjinë nga Maqedonia.

Nga takimet me diasporën, Ademi tregon se problemi i parë me të cilin ata përballen është se kur vijin për të kryer ndonjë çështje administrative dhe burokratike, ata hasin në mungesë të informacionit se ku duhet të drejtohen për një çështje të caktuar.

Prandaj, Ademi thekson nevojën për të hapur zyra për bashkëpunim me diasporën në komunat e Maqedonisë. Në këtë kontekst, shpjegon ministri përgjegjës për diasporën, Manuali për të Shpërngulurit të cilin së fundmi e ka promovuar Agjencia e Emigrimit e Maqedonisë është me dobi të madhe për diasporën dhe përmban informata të dobishme për të cilat ata kanë nevojë.

Roli i diasporës në kushtet e ekonomisë në vend është me rëndësi të madhe, thotë ministri Ademi, duke shpjeguar se Qeveria ka bërë përpjekje për të mbështetur investimet që vijnë nga diaspora. "Segmenti ekonomik po ashtu është shumë i rëndësishëm dhe në atë pjesë nga ajo që zyrtarisht ekziston në Bankën Popullore, në baza vjetore rreth 460-500 milionë euro hyjnë zyrtarisht, përmes atyre kanaleve bankare apo transferi i parave. Megjithatë, jozyrtarisht, numrat arrijnë edhe deri në një miliardë, që është një kapital mjaft i madh që hyn në Republikën e Maqedonisë", thekson Ademi.

Ministri i angazhuar për diasporën bën të ditur gjithashtu se që moti, Qeveria e Maqedonisë si mbështetje të proceseve të investimeve, ka sjellë edhe Ligjin për mbështetje të investimeve, të cilin Parlamenti e miratoi, dhe për herë të parë përveç investitorëve të huaj dhe vendas të cilët do të marrin mbështetje nga shteti në varësi të investimeve, edhe investitorët e diasporës janë vendosur veçmas.

Kufizimet ligjore me qëllim të vendosjes së standardeve të shkollat e doktoraturës kanë prerë hovin e megalomanisë sa i takon ofertave akademike. UKM që për vitin 2018/2019 ofron 11.661 vende për studimet deridiplomike, 4647 vende për studime master dhe vetëm 870 për studime të doktoraturës, UT nuk ka hapur ende konkurs për studime të shkallës së tretë, ndërsa në UEJL për studimet e shkallës së tretë ofrohen vetëm 37 vende

STUDIMET PASUNIVERSITARE

AKREDITIMI I MENTORËVE ULË NUMRIN E DOKTORATURAVE



qërore. Universitetet bëjnë garë se cili të hapë më shumë programe studimore dhe kush të ofrojë numër më të madh vendesh për regjistrimin e studentëve.

Mirëpo, kufizimet ligjore me qëllim të vendosjes së standardeve të shkollat e doktoraturës kanë prerë hovin e megalomanisë sa i takon ofertave për këtë lloj studimesh. Ka universitete, të cilat nuk kanë fituar ende të drejtën e hapjes së studimeve të shkallës së tretë dhe numri i tyre nuk është i vogël, ashtu sikurse ka të tjerë ku ky numër është krejt simbolik. Gjithë kjo shpjegohet me kërkesën që numri i vendeve të doktoraturës të jetë në raport të drejt me

numrin e mentorëve të akredituar. Kështu, universitetet përveçse duhet të kenë të akredituar paraprakisht programet studimore të shkallës së tretë që të mund të hapin Konkurs për pranimin e kandidatëve doktorantë (për studime të doktoraturës), ato duhet që të kenë edhe numrin e nevojshëm të mentorëve të akredituar. Ky lloj certifikim i mentorëve, i cili kalon përmes Këshillit të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Maqedoni, me automatizëm ka zvogëluar kotat e studimeve të doktoraturës në Maqedoni, pasi nënkupton plotësimin e predispozitave paraprake për studime të atij niveli. Cilësia e studimeve janë

pastaj diçka tjetër, e cila nuk varet vetëm nga numri i mentorëve të akredituar, por që padyshim duke reduktuar sasinë krijon pak më tepër kushte ose jep shpresë edhe për cilësi. Këto lëvizje mund të vërehen edhe në disa prej universiteteve me të rëndësishme në vend sikurse janë ai i Shkupit, Tetovës apo Evropës Juglindore. Nga të tre këto universitete, vetëm Universiteti "Kirili dhe Metodi" në Shkup (UKM) ofron numër më të madh të vendeve për studime deridiplomike - 832 gjithsej. Universiteti i Tetovës (UT) nuk ka fare studime të shkallës së tretë për vitin akademik 2018/2019, ndërsa Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) ofron vetëm 37 të tilla.

Në të tre këto universitete, pa përjashtuar edhe UKM-në që në dukje të parë lë përshtypjen e institucionit me ofertë të begatshme të studimeve të shkallës së tretë, bazuar në numrin e vendeve për studimet e ciklit të tretë, mund të konstatohet gjendja jo aq e mirë sa i takon nivelit të profesorëve universitar që janë të angazhuar në këta institucione. Për të marrë kualifikimin mentor i akredituar, sigurisht që kandidatët duhet të plotësojnë disa kriteret më të larta shkencore, të cilat mund ti japin të

drejt institucionit të planifikojë hapjen e studimeve të doktoraturës. Nuk ndodh kështu me studimet master dhe studimet deridiplomike për çka flasin dhe shifrat. UKM-ja, për shembull, për vitin e ardhshëm akademik ka hapur Konkurs për 11.661 vende në studimet deri diplomike. Niveli universitar është atë 5.913 në kotën e studimeve të rregullta, 4.573 në kuotën e studimeve me bashkëfinancim dhe 1.175 në kuotën e studimeve me korrespondencë. Ndërsa për studimet e shkallës së dytë, niveli i studimeve të magjistraturës janë hapur 4.647 vende. Pra si numri i studimeve deri diplomike, ashtu edhe i atyre të shkallës së dytë është shumë larg numrit të vendeve për studimet e shkallës së tretë, të doktoraturës (870). Kështu ndodh edhe me UT-në ku janë hapur 3.185 vende për studimet deri diplomike, 1.104 vende për studimet master dhe asnjë për studimet e doktoraturës. Në UEJL janë ofruar 1.205 vende për studime deridiplomike dhe 700 vende për studimet master (520 dy vjeçare, për programet 3+2 dhe 280 një vjeçare për programet 4+1). Mirëpo, numri i vendeve për studimet e shkallës së tretë nuk kalon kuotën e 37 vendeve në 5 fusha shkencore.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 10 korrik - Studimet e shkallës së tretë, apo shkollat e doktoraturës sikurse njihen tani këto lloj studimesh nëpër institucionet e arsimit të lartë, në Maqedoni janë rrudhur së tepërmi nëse krahasojmë numrin e vendeve të planifikuara për studimet e doktoraturës të krahasuara me numrin e vendeve të planifikuara për studimet e magjistraturës. Për numrin e vendeve që ofrohen për studime të ciklit të parë, tanimë dihet prej kohësh. Rritja enorme e vendeve të planifikuara për studime deridiplomike është kthyer në mani sho-

Mesatarja e Komunës Çair është vetëm 3.65. Shkolla fillore "Liria", e njohur dikur si një ndër shkollat më të mira në Shkup, këtë vit ka përfunduar me rezultate dëshpëruese - 3.35 notë mesatare. Ajo ka arritur mesataren më të ulët ndaj të gjitha shkollave fillore që gravitojnë në Çair

Koha Aida XHONI

Shkup, 10 korrik - Filloristët e Komunës Qendër kanë marrë vitin e kaluar më shumë pesëshe, e pasuar nga shkollat e Komunës së Karposhit dhe Aerodromit. Nota më të dobëta kanë nxënësit në shkollat fillore të Shuto Orizarës dhe Sarajit.

Nëse analizohen të dhënat për notat në nivel të Qytetit të Shkupit, del se më së shumti për pesëshe luftojnë nxënësit që mësojnë në Qendër. Atje, në fund të vitit të ka-

PËR PESËSHE MË SË SHUMTI LUFTOJNË SHKOLLAT MAQEDONASE

SHKOLLAT SHQIPE MË TË DOBËTA NË SHKUP



luar shkollor, mesatarja e notës ka qenë 4.57, në Aerodrom 4.31, në Karposh 4.32. Dysha dhe tresha më shumë kanë marrë nxënësit në Shuto Orizarë, ku mesatarja ka qenë 2.99 dhe në Saraj me mesatare 3.56. Shkolla fillore "Koço Racin" në Qendër ka notë më të lartë mesatare edhe atë 4.75, ndërsa shkolla me nota më të dobëta është "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid" nga Shuto Orizarja me notë mesatare 2.99. Mesatarja e Komunës Çair

është vetëm 3.65. Shkolla fillore "Liria", e njohur dikur si një ndër shkollat më të mira në Shkup, këtë vit ka përfunduar me rezultate dëshpëruese - 3.35 notë mesatare. Ajo ka arritur mesataren më të ulët ndaj të gjitha shkollave fillore që gravitojnë në Çair. Sukses më të mirë kanë shkollat fillore "Idninina" (4.34), "Rajko Zhinzifov" dhe "Hasan Prishtina" (mesatare 3.85), "7 Marsi" me mesatare 3.81, pastaj renditet shkolla fillore "Tefejjuz"

me mesatare 3.67, "Nikolla Vaprov" 3.60, "Jashar Bej Shkupi" - 3.54, "Kongresi i Manastirit" 3.43, "Vasill Gllavinov" 3.43, "Liria" me mesatare 3.35. Shkolla fillore "Liman Kaba" në fshatin Luboten të Komunës së Butelit vitin e kaluar shkollor ka arritur mesatare 3.82. Edhe "Zhivko Brajkovski" në Butel ka marrë notë mesatare 3.82, "Panajot Ginovski" ka arritur notë mesatare 3.97, derisa shkolla fillore "Petar Zdravkovski Penko" ka arritur note mesatare

3.87. Shkolla fillore "25 Maji" në Hasanbeg, Komuna e Gazi Babës, ka arritur mesatare prej 3.90, shkolla fillore "Joakim Kërçovski" nga fshati Nigishtan ka arritur mesatare prej 3.72, "Vëllazërimi" në Karposh ka notë mesatare 4.08, "Bajram Shabani" në Kondovë me notë 3.42, "Dituria" e Sarajit me 3.53, "Drita" në Rashçe notë mesatare 3.52, "Emin Duraku" në Bukoviq me notë mesatare 3.65, "Faik Konica" në Radushë 3.61, "Ibe Palikuqi" e Bojanës me notë 3.39, "Sami Frashëri" nga fshati Gllumovë 3.80, "Emin Duraku" nga fshati Rahoviq me 3.93, "Sami Frashëri" në Matkë me notë mesatare 3.95, "Dituria" në Gërçec me notë mesatare 3.39, "Ibe Palikuqi" në Llaskarcë 3.59, "Bedri Tahiri" e Svillares së Poshtme 3.43...

Shkollat e Shuto Orizarës kanë notë mesatare 2.99, edhe atë shkolla fillore "26 Korriku" ka arritur mesatare prej 3.25, ndërsa shkolla "Vëllezërit Ramiz dhe Hamid", mesatare vetëm 2.99.

Gjopa për 82 shoferë për parkim jo të drejtë

Shkup, 10 korrik - Një këmbësor është lënduar rëndë, ndërsa katër persona janë me lëndime të lehta trupore nga gjithsej njëmbëdhjetë fatkeqësitë e komunikacionit që në njëzetë e katër orët e kaluara kanë ndodhur në rajonin e Shkupit. Dëm material është shkaktuar në pesë aksidente. Të dhënat e buletinit të SPB Shkup tregojnë se 47 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, ndërsa nga komunikacioni janë përjashtuar një shofer i cili e ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 18 të cilët e kanë drejtuar automjetin para se ta fitojnë të drejtën për të drejtuar automjetin dhe një fillestar. Tre shoferë e kanë kaluar udhëkryqin në semafor të kuq, ndërsa pesë nuk u kanë dhënë përparësi kalimi automjeteve. Nga komunikacioni janë përjashtuar edhe 22 automjete prej të cilave 20 të paregjistruara dhe dy me defekte. Policia e trafikut i ka sanksionuar 82 shoferë për parkim jo të drejtë, ndërsa 61 automjete janë larguar nga automjeti special "karrotreci". Tek këmbësorët, gjashtë e kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë dhe gjashtë në semafor të kuq. Njëmbëdhjetë persona me motor, moped apo motoçikletë nuk e kanë përdorur helmët mbrojtëse.

Komuna e Tetovës gjatë vitit 2016 ka ndarë rreth gjashtë milionë denarë për një studim fizibiliteti mbi gazifikimin e Tetovës. Sipas informacioneve, fillimisht planifikohet gazifikimi i shkollave dhe institucioneve tjera publike dhe më pas - i gjithë qytetit, përfshi edhe amvisëritë

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 10 korrik - Krahas Ministrit të Transportit, Goran Sugarevski, i cili disa herë ka paralajmëruar se Tetova do të përfshihet në rrjetin e gazifikimit deri në fund të vitit 2020, edhe nga Komuna e Tetovës shprejnë se brenda dy viteve kjo çështje do të përfundojë.

"Nga bisedat që i kemi pasur, normalisht jozyrtare, me drejtorin e resurseve energjetike, ata janë optimist se Tetova do të përfshihet në trasenë kryesore, dhe nëse nuk gaboj - ata kanë arritur deri në anën e Gostivarit me punë, dhe janë shumë optimist se deri në vitin 2020, kjo çështje do të përfundojë", shprehet Armend Fazliu, zëdhënës i Komunës së Tetovës. Nga komuna njoftuan se fillimisht në rrjetin e gazifikimit do të kyçen vetëm institucionet publike, ndërsa më pas edhe amvisëritë.

"Nëse kalon gypi kryesor, në bisedat që i ka patur kryeministri Zoran Zaev me kryetaren e Teuta Arifi, është theksuar se do të mund që edhe amvisëritë tjera do të

FILLIMISHT INSTITUCIONET, PASTAJ AMVISËRITË

GAZIFIKIMI NË TETOVË PËRFUNDON PËR DY VITE



mund të përfshihen, por fillimisht do të kyçen institucionet publike që më pastaj do të shihen edhe modalitetet tjera që tërë qyteti të përfshihet në gazifikimin", tha Fazliu. Ai më tej ka sqaruar se Komuna e Tetovës do të themelojë edhe një ndërmarrje që do të menaxhojë me gazifikimin në qytetin e Tetovës.

"Punët i kryen kompania që ka fituar tenderin nga Drejtoria për menaxhim me resurset energjetike, ndërsa komuna në këtë rast do të duhet vetëm të ofrojë kuadrot e veta ku do të themelohet vetëm një ndërmarrje publike që do të jetë enkas për gazifikim. Çdo qytet do të ketë ndërmarrjen e vet për gazifikim dhe do të jetë një ndërmarrje qendrore që do të me-

naxhojë me të gjitha ndërmarrjet publike, pra ashtu siç e ka Qyteti i Shkupit ngrohtoren që kujdeset për këtë çështje", deklaroi Fazliu. Sipas informacioneve, deri në muajin mars është realizuar vetëm 17 për qind nga procesi i gazifikimit, në shtrirje prej Shkupit e deri në Gostivar. Rruga nacionale e gazsjellësit do të përfundojë në hyrjen e komunave, që më pas Qeveria lokale ta dërgojë deri tek amvisëritë, nëpërmjet vetë-investimit, partneritetit publiko-privat ose ndonjë kompani private, e cila do ta ndërtojë rrjetin deri në shtëpitë e qytetarëve. Përndryshe, Komuna e Tetovës gjatë vitit 2016 ka ndarë rreth gjashtë milionë denarë për një studim fizibiliteti mbi gazifikimin e Tetovës. Sipas

informacioneve, fillimisht planifikohet gazifikimi i shkollave dhe institucioneve tjera publike dhe më pas edhe i gjithë qyteti, përfshi për amvisëritë për ngrohje. Sipas të dhënave, faza e parë e projektit përfshin gazifikimin deri në Tetovë dhe Gostivar, kurse gjatësia arrin 76 km. Ndërkaq, Qeveria ka siguruar 90 milionë euro për instalimin e plot 204 kilometra rrjet gazsjellës. Sipas ekspertëve, nevoja është imanente për sjelljen e gazifikimit në Pollog. Sipas tyre, ajo që është e rëndësishme dhe më e kushtueshme është shpërndarja, gjegjësisht rrjeti shpërndarës i gazifikimit deri tek arteriet kryesore dhe mandej kyçjet e familjeve individuale dhe kapaciteteve industriale.

GOSTIVARI MIRËPRET MËRGIMTARËT

"MIRË SE VINI MËRGIMTARË"

Gostivar, 10 korrik - Nën moton "Mirë se vini mërgimtarë", sivjet Komuna e Gostivarit do t'i mirëpret në mënyrë dinjitoze mërgimtarët tanë dhe do tu mundësojë atyre një qëndrim të këndshëm në vendlindje gjatë pushimeve verore, njofton Departamenti për Informim i kësaj komune. Hapi i parë që ndërmori Komuna e Gostivarit në këtë drejtim është riaktivizimi i Zyrës së Mërgimtarëve në kuadër të administratës komunale prej më 1 korrik dhe e cila do të qëndrojë e hapur deri më 31 gusht, ndërsa ofron shërbime falas nga 12 orë në ditë. Krahas kësaj, gjatë qëndrimit në vendlindje, mërgimtarëve u mundësohet që pa pagesë t'i dërgojnë fëmijët e tyre të moshës pa-

rashkollorë në çerdhet e Gostivarit, për çka tashmë Komuna ka siguruar kuadër plotësues, si dhe ndjekjen e kurseve falas të gjuhës shqipe.

Për t'ju dëshiruar mirëseardhje, në ditët kur fluksi i mbërritjes së mërgimtarëve do të jetë më i madh, aktivistët e Forumit Rinor të shoqëruar edhe nga administratorët komunal, në hyrje të qytetit do tu ndajnë atyre fletushka me agjendën e aktiviteteve kulturore-sportive të projektit "Ditët e mërgimtarëve". Aktivitetet e ndryshme kulturore-zbavitëse dhe rekreativo-sportive do të fillojnë më 15 korrik (e diel) në sheshin e qytetit me shfaqjen e Stand Up komedisë në performancë të humoristit të

mirënjohur Hasim Memishi Sopi. Ndërsa nga aktivitetet kulturore, janë paraparë edhe dy shfaqje tjera teatrale. Në agjendën e pasur janë përfshirë edhe disa koncerte, një me këngë dhe valle folklorike, një me këngë zbavitëse shqipe, një koncert rinor multietnik dhe një me llahije. Për fëmijët do të organizohet një koncert special si dhe një kuiz diturie, ndërsa në agjendë është edhe organizimi i një turniri në futboll të vogël, turnir shahu dhe Tuning Showme automobila.

Komuna e Gostivarit, mërgimtarët i konsideron si një kategori mjaft e rëndësishme qytetarësh si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror, andaj me qëllim që të ata të mos i shkëpusin lidhjet me



atdheun dhe të vazhdojnë të mbeten faktor kyç për zhvillimin ekonomik të vendit, do të bëjë përpjekje maksimale që qëndrimin në vendin e tyre të originës, t'ua bëjë më tërheqës dhe t'i joshë brezat e rinj që ta vizitojnë rregullisht Gostivarin. Komuna e Gostivarit synon që në këtë drejtim të shërbejë si një shembull pozitiv që do ta ndjekin edhe komunat tjera të vendit, si dhe Qeveria. Për vitin e ardhshëm, Komuna e Gostivarit

planifikon të zgjerojë aktivitetet e saj në periudhën e pushimeve, ndërkaq inkurajon edhe sektorin civil dhe sektorin e biznesit që të ndërmarrin aktivitete të ndryshme dhe të bashkëpunojnë me Komunën, me të vetmin qëllim që Gostivari të bëhet destinacion i preferuar jo vetëm për mërgimtarët nga Gostivari me rrethinë, por edhe nga komunat fqinje, njofton Departamenti për Informim i kësaj komune. (U.H)

Impakti gjeopolitik i Marrëveshjes Greqi-Maqedoni



Nga
Dr. Blerim REKA

U deshën 27 vite të vështira, të ndërmjetësuar nga OKB-ja për Republikën e Maqedonisë për të siguruar një marrëveshje me Greqinë me një emër të ri. Marrëveshja, e aritur nga dy kryeministrit: Zaev dhe Tsipras, më 17 qershor 2018, hap rrugën për atë që së shpejti do të jetë Republika e Maqedonisë Veriore për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian dhe NATO. Dy proceset ishin bllokuar nga vetoja e Greqisë që nga viti 2006.

Por me gjithë arritjen e marrëveshjes bilaterale, pritet një proces i komplikuar implementues në dy vitet në vijim. Proceduralisht, ashtu edhe dhe politikisht, mbeten për tu zbatuar dy detyra të vështira. Kundërshtarët në të dy vendet (duke përfshirë edhe presidentin e Maqedonisë) tashmë po mbledhin opozitën populiste kundër marrëveshjes. Në rajon, ndërkaq marrëdhëniet më të ngrohta midis: Athinës dhe Shkupit; dhe potencialisht, midis Greqisë dhe Tiranës; nuk do të mirëprehen nga Turqia, e cila tashmë ka shtrirë me vite ndikimin e saj në Ballkan. As Rusia nuk do të jetë e "lumtur", pasi që kundërshton anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Është shumë e mundshme që zbatimi i kësaj marrëveshjeje, do të kërkojë më shumë kohë. Megjithatë, tashmë janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm: Kuvendi i Maqedonisë, e ratifikoi marrëveshjen, fillimisht më 20 qershor dhe pastaj edhe më 5 korrik, pasi presidenti Gjorgje Ivanov refuzoi të miratonte marrëveshjen, duke argumentuar se ajo "shkel Kushtetutën". Më 25 qershor, Ministria e Jashtme e Greqisë njoftoi zyrtarisht me shkresë, BE-në dhe NATO-n se heq veton mbi kërkesën e Maqedonisë për t'u bashkuar këtyre organizatave.

Jo rastësisht, vetëm pesë ditë pas marrëveshjes midis Athinës dhe Shkupit, ministrit e financave të eurozonës ranë dakord mbi një plan për të lejuar Greqinë të dalë nga programi i saj i shpëtimit tetëvjeçar. "Kriza greke përfundon këtu sonte", tha komisionari i çështjeve ekonomike të BE-së, Pierre Moscovici. Shumë shpejt, marrëveshja për të dyja palët duket se po kthehet në një fitore të dyanshme: Win-Win.

SFIDAT PROCEDURALE

Megjithatë, mbetet një rrugë e gjatë. Këtë vjeshtë, Maqedonia pritet të mbajë një referendum për ndryshimin e emrit - nëse mbështet

tet me më shumë se gjysma e më pak se 1 milion votuesve të saj. Pas tij, amendamentet kushtetuese duhet të aprovohen para fundit të vitit, me një shumicë prej dy të tretash në Parlament, ndërkohe që tash qeveria ka vetëm 69 prej 80 votave të kërkuara. Vetëm pas tejkalimit e këtyre dy pengesave, Parlamenti i Greqisë do të ratifikojë të njëjtën marrëveshje. Maqedonia mbase do të marrë ftesën për NATO, në Samitin e saj më 11-12 korrik, por ratifikimi i anëtarësimit të vendit, mund të marrë të paktën dy vite (siç në rastin e Malit të Zi: 2015-2017). Siç deklaroi kryeministri grek Alexis Tsipras (më 29 qershor, pasi takoi sekretarin e përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg): "Së pari zbatimi i marrëveshjes, pastaj anëtarësimi në NATO".

Sa për BE-në, Maqedonia (dhe Shqipëria) nuk do t'i nisin negociatat anëtarësuese këtë vit. Më 29 qershor, Këshilli Evropian miratoi vendimin që data e fillimit të këtyre negociatave të shtyhet deri në qershor të vitit 2019. Pasi të fillojë "procesi i skrinimit" i BE-së, pranimi parashihet të zgjasë rreth tetë vjet (deri në vitin 2027), me një vit tjetër ose dy për ratifikim. Mirëpo, vetëm, nëse zgjerimi mbetet në agjendën e BE-së në dekadën e ardhshme, gjë që tash nuk është, duke marrë parasysh mos-mbështetjen e kësaj politike, nga disa shtete anëtare, si Franca,

Holanda dhe Danimarka. Edhe pranimi i Maqedonisë në OKB do të jetë i ndërlikuar pasi ndryshimi i emrit do të kërkojë veprime të mëtejshme nga shtetet anëtare që tashmë e kishin njohur vendin nën emrin e tanishëm kushtetues - Republika e Maqedonisë. Derisa rruga teknike (procedurale) është relativisht mirë e precizuar, aspektet politike janë shumë më pak të parashikueshme; si në vend ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Si do të reagojnë kundërshtarët e marrëveshjes në Maqedoni dhe Greqi dhe çfarë do të bëjnë fuqitë rajonale dhe ato të mëdha?

POLITIKA E BRENDSHME

Në Maqedoni, duket se të paktën dy parti politike do të vazhdojnë të kundërshtojnë "marrëveshjen e emrit të ri". Njëra është VMRO-DPMNE, (partia kryesore e opozitës, e cila e quajti marrëveshjen "kapitullim" dhe "tradhti kombëtare"). Partia tjetër është e vogël (Maqedonia e Bashkuar, e cila ka organizuar demonstrata kundër marrëveshjes me flamuj maqedonas dhe rusë dhe udhëheqësi i saj Janko Bachev nuk e ka fshehur që partia është me Kremlinin).

Së fundja, Presidenti Gjorgje Ivanov, ka refuzuar dy herë të nënshkruajë marrëveshjen, duke thënë se është "jokushtetuese". Ky veprim

Marrëveshja epokale midis Greqisë dhe asaj që nga tani do quhet Republika e Maqedonisë Veriore është shumë më tepër se sa një emër. Marrëveshja bilaterale përfundimisht hap dyert e integritit të saj në BE dhe NATO. Por sfidat politike mund të vonojnë procesin, së paku dyvjeçar implementues



mund të sjell krizë kushtetuese, pasi që presidenti nuk mund të refuzojë nënshkrimin e ligjit që është miratuar nga parlamenti për herë të dytë. Bojkoti i tij, i kombinuar me demonstrata të rregullta rrugore të organizuara nga partitë e opozitës, do të mbajë atmosferën politike të tensionuar dhe të paqëndrueshme, sa më shumë afohet referendumi i vjeshtës. Dy fuqitë e jashtme nuk e fshehën pakënaqësinë e tyre. Zyrtarët rusë thanë se nuk kishin "asgjë kundër marrëveshjes", por u kujdesën për t'i nënvizuar shqetësimet e tyre se do të lejonte Maqedoninë t'i bashkohej NATO-s. Serbia ishte më eksplicite, duke mos uruar Qeverinë maqedonase për përparimin diplomatik. "Nuk kemi asgjë për të uruar", tha ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić.

Greqia ka po aq kundërshtar të brendshëm. Partia kryesore e opozitës, Demokracia e Re, ka kritikuar marrëveshjen, ndërsa partnerja e koalicionit të kryeministrit Alexis Tsipras, Grekët e Pavarur (ANEL), thotë se do të kundërshtojë marrëveshjen nëse nuk miratohet nëpërmjet një referendumi nacional apo zgjedhjeve të reja. Mosmarrëveshja për këtë çështje brenda qeverisë është e rëndësishme, pasi Tsipras duhej t'i mbijetonte mocionit të mosbesimit në Parlament vetëm një ditë përpara nënshkrimit të "marrëveshjes së emrit të ri".



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaška lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 10 korrik | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Gjykata Kushtetuese greke gjithashtu ka pranuar kërkesën për anulimin e marrëveshjes. Megjithatë, kryeministri grek, së paku gëzon një avantazh ndaj homologut të tij maqedonas: Presidenti grek, Prokopis Pavlopoulos, ka deklaruar mbështetjen e tij.

RIVALITETET RAJONALE

Ndikimi rajonal i marrëveshjes bilaterale është një tjetër rrëfim. Greqia mund të ketë zgjidhur një çështje me Maqedoninë, por mbetet me çështje të hapura me dy fqinjët e tjerë: Shqipërinë dhe Turqinë. Dyjat, kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet territoriale, veçanërisht mbi të drejtat e rezervave të naftës dhe të gazit në det të hapur. Në rastin e Shqipërisë, çështja kryesore e mosmarrëveshjes është shiriti detar prej 140 kilometrash e detit Jon; me Turqinë, ndërkaq janë Ishujt Egje dhe Qiproja e Veriut. Grupet punuese diplomatike shqiptare dhe greke, duket se janë afër përfundimit të një marrëveshjeje për Detin Jon, por opozita shqiptare kritikon për "falje" të territorit të kontestuar. Fillimisht, të dyja palët kishin shpresuar të nënshkruanin një marrëveshje përfundimtare para takimit të Këshillit Evropian në Bruksel më 28-29 qershor, e cila ishte anuluar në moment të fundit. Pritet që dy kryeministrat ta diskutojnë përparimin në margjinat e samitit të Ballkanit Perëndimor në Londër, që filloi më 10 korrik 2018.

Një afrim i mundshëm mes Athinës, Shkupit dhe Tiranës do përcillet me shumë kujdes nga Ankaraja. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, Turqia ishte fuqia kryesore rajonale në Ballkanin - si ekonomikisht, (nëpërmjet tregtisë së konsiderueshme dhe investimeve), ashtu edhe në aspektin kulturor, (përmes programeve për të promovuar gjuhën dhe kulturën turke nëpërmjet shkollave turke lokale).

Në pesë muajt e parë të vitit 2018, eksportet e Turqisë në Ballkan u rritën 22 për qind, ndërsa Agjencia Turke për Çështje Kulturore rriti donacionet e saj për kulturën dhe arsimin në rajon. Zyrtarët e lartë turq kanë lidhje të ngushta personale me homologët e tyre në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi. Ndjenja pro-turke është gjithashtu e dukshme në disa pjesë të popullsisë, siç u pa nga festimet e rrugëve në disa qytete të Ballkanit Perëndimor pas fitores së presidentit Rexhep Tajip Erdogan në zgjedhjet presidenciale të 25 qershorit në Turqi. Ri-rregullimi i marrëdhënieve të Greqisë me fqinjët e saj, do të zhvendoste busollën gjeopolitike midis Athinës dhe Ankarasë. Turqia tashmë ka bërë një investim të madh financiar dhe kulturor në rajon. Greqia, ndërkaq duke zhbllokuar procesin e integritimit euro-atlantik për fqinjët e saj verior, mund të bëhet një lojtar më i madh Euro-Atlantik dhe të riformësojë bilancin rajonal.

FUQITË EMËDHA

Elementi i tretë në këtë trekëndësh rajonal është përfshirja e fuqive të mëdha. Rusia ka kundërshtuar fuqishëm anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, duke ushtruar ndikim nëpërmjet aleatit të saj më të madh rajonal - Serbisë. Megjithatë, marrëdhëniet më të ngrohta midis Moskës dhe Ankarasë do të tentojnë të punojnë kundër ndikimit të Greqisë në Ballkanin Perëndimor - veçanërisht tani që Athina po rishfaqet si një lojtar konstruktiv. Kjo mund të shihet edhe nga toni më i lehtë në marrëdhëniet e ShBA-Greqi. Në dëgjimin par Senatin Amerikan, ndihmës Sekretari amerikan i Shtetit Wes Mitchell tha: "Ne po e mbajmë Greqinë si një spirancë të stabilitetit në Mesdhe dhe në Ballkanin Perëndimor". Uashingtoni ishte një nga të parët që përgëzoi Maqedoninë dhe Greqinë për marrëveshjen e tyre bilaterale dhe zëvendëspresidenti i ShBA-së Pence, përgëzoi dy kryeministrat Zaev dhe Tsipras, vetëm pesë ditë përpara samitit të NATO-s. Këto sinjale duket se do lëkundin kambanat diplomatike të Ankarasë.

Po aq duhet të shqetësohet edhe Moskë. Pasi të zgjidhen mosmarrëveshjet Greqi-Maqedoni dhe

Greqi-Shqipëri, hapet rruga për strategjinë euro-atlantike në Ballkan. Me Greqinë, Turqinë dhe Shqipërinë tashmë anëtarë të NATO-s dhe Maqedoninë që do të bashkohet, siç e bëri vjet Mali i Zi, matematika rajonale do të ndryshojë vendosmërisht kundër Kremlinit.

Kjo është arsyeja pse disa anëtarë të BE-së, kritikuan vendimin për të vonuar bisedimet e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, duke argumentuar se kjo do të ndihmojë vetëm në nxitjen e ndikimit rus. Është e qartë se politika e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor ka një ndikim të rëndësishëm gjeopolitik. Largimi i rajonit nga sfera Euro-Atlantike, do të paraqiste një rrezik të madh gjeopolitik.

SKENARËT: RIVALITET OSE NDARJE

Skenari më i mundshëm është se Greqia do të ketë sukses në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të saj bilaterale me fqinjët e saj verior. Kjo do të mbyllte unazën jugore të NATO-s, por do t'i sfidojë marrëdhëniet me Turqinë. Deri tani, Ankaraja ka ushtruar ndikim vendimtar në Maqedoni dhe Shqipëri. Po aq po rritet ndikimi i Turqisë në Serbi, ku qeveria e Beogradit po tërheq investimet turke. Edhe Moskë dhe Ankaraja do preferonin Beogradin si një lider rajonal, duke kundërshtuar përpjekjet e ShBA-së për të mbështetur Athinën.

Duke qenë anëtare e NATO-s, vështirë që Turqia do mund të punojë shumë ngushtë me Moskën. Si rezultat, nuk do të ketë opozitë turke ndaj aspiratave të Maqedonisë për në NATO. Por, në vend të kësaj, Ankaraja do t'i përqendrojë përpjekjet e saj në bllokimin e Athinës nga të qenit një lojtar rajonal.

Skenari i dytë, më pak i mundshëm, është që Turqia dhe Greqia të bien dakord mbi sferat e tyre të ndikimit në Ballkanin Perëndimor. Dy parametrat kryesorë për çdo ndarje të tillë do të ishin energjia dhe kultura. Sa i përket energjisë, ndarja do të bëhej në bazë të projekteve kundërshtuese gazsjellëse: "Rrjedha Turke" e Rusisë dhe Gazsjellësi "Trans Adriatik Pipeline" (TAP), i BE-së, pjesë e Korridorit Jugor më të madh të gazit. Për Ankarën dhe Moskën, një nga çelësat e projektit të Rrjedhës Turke është bashkëpunimi me Maqedoninë dhe Serbinë, që gazi të arrijë tregun e BE-së nëpërmjet Hungarisë. Sa i përket TAP-it, Greqia duhet të punojë me Shqipërinë, (por ehe Kosovën dhe Malin e Zi) për t'i siguruar dërgesat në Itali, drejt BE.

Në aspektin kulturor, Ballkani Perëndimor, poashtu mund të ndahet midis Turqisë dhe Greqisë përgjatë vijave fetare. Nëse kjo do të ndodhte, do të krijonte ndarje sektare përgjatë vijave në Europë, sipas modelit të Lindjes së Mesme. "Ballkani Ortodoks", (Serbia dhe pjesët e Maqedonisë), do të dominohej nga Rusia.

Vendet me shumicë myslimane (Shqipëria, Kosova dhe një pjesë e Maqedonisë) do të dominohehin nga Turqia. Mirëpo, ky skenar në praktikë, është më pak i besueshëm për shkak të hartës së ndërlikuar fetare - e cila përshkon pothuajse të gjithë kufijtë shtetëror. Serbia është kryesisht ortodokse dhe me ndikim të fortë rus, por përmban të paktën dy territore kompakte me shumicë populsi myslimane - Sanxhaku (shumica boshnjake etnike) dhe Lugina e Preshevës (shumicë etnike shqiptare). Bosnjë dhe Hercegovina është edhe më keq, pasi është e ndarë përgjatë vijave fetare dhe politike. Republika Srpska, me shumicën e saj serbe, mban lidhje të ngushta me Beogradin dhe Moskën, ndërsa Federata (e ndarë midis boshnjakëve dhe kroatëve) kërkon udhëzime nga Turqia dhe BE-ja.

Ndarja fetare duket e pamundur, vetëm në Shqipëri dhe Kosovë, shtetet më pro-amerikane në Ballkan, sepse shqiptarët edhe pse kanë tre religjione, ato kurrë nuk kanë pasur asnjë luftë fetare gjatë historisë.

(Botuar në Geopolitical Intelligence Service. Nga anglishtja përktheu dhe përshtati: Arsim Osmani)

Gazetarët duhet të rikthehen në terren



Nga Bernard GUETTA

Nuk është pak, sigurisht, por ai moment as nuk i vuri në diskutim elementet mbi të cilat ishte ngritur stabiliteti ndërkombëtar, pas humbjes së nazizmit. Askush nuk e kontestonte multilateralizmin. Përkundrazi, patëm ndjesinë se do të përforcohej nga fundi i antagonizmit mes botës së lirë dhe bllokut sovjetik. Që atëherë, aleanca atlantike që bashkonte demokracitë perëndimore (evropiane dhe amerikano-veriore) ka pranuar të tjera shtete. Bashkimi Evropian është zgjeruar dhe konsoliduar përmes monedhës së përbashkët. Demokracia është përhapur në pesë kontinente. Dikush madje ka menduar, se edhe Kina do të bëhej demokraci, falë përmirësimit të cilësive së jetesës.

Pas vitit 1989, bota dukej më e bashkuar se kurrë, e forcuar prej vlerave të përbashkëta apo të pakontestuar, si universaliteti i të drejtave të njeriut, shkëmbimi i lirë dhe detyrimi për të provuar e zgjidhur të gjithë konfliktet, politike dhe ekonomike, përmes negociatave, për të cilat Organizata Botërore e Tregtisë dhe rregullat e saj ishin një shembull i përsosur. Zgjidhja e Donald Trump, Brexit, rritja e nacionalizmit dhe rilindja e të djathtës ekstreme që ka marrë pushtetin në disa vende të BE, një bastion i demokracisë, janë shenja të një ndryshimi epokal, më të thellë se ai që ishte në origjinë të shembjes së Murit.

Presidenti i SHBA, demokracia më e pasur dhe më e fuqishme, nuk ka skrupuj kur shkëput fëmijët nga krahët e nënave të tyre, në emër të luftës kundër imigrimit, apo të vendosë tarifa doganore për çelikut dhe aluminit e prodhuar nga aleatët e vet evropianë, si dhe të sulmojë NATO-n, duke e akuzuar se është tepër e kushtueshme dhe në thelb, e kotë. Në një moment kur Kina manifeston një forcë ushtarake të pashoqe dhe ku fuqitë e reja ekonomike kontestojnë dhe dobësojnë dominimin perëndimor, që e ka filluesën qysh në kohën e Rilindjes, presidenti amerikan nuk heziton të çmontojë frontin perëndimor.

Për të, aleanca nuk ka kurrfarë rëndësie, sepse mbrojtja e Evropës nuk i intereson dhe nuk do t'i ketë duart e lidhura nga cilado marrëveshje. Vetëm dy gjëra kanë rëndësi, në sytë e Trumpit: interesi i SHBA dhe marrëdhënia e forcës me Kinën. Në ndërkohë, lista e fuqive, të mëdha e të vogla, që nuk duan të ndjekin më rregulla të përbashkëta vazhdon të zgjatet: Kina, Rusia, Turqia, Arabia Saudite, Irani, Izraeli, Hungaria, Mbretëria e Bashkuar dy vjet më parë dhe tani në fund, Italia.

E parë në retrospektivë, rënia e Murit të Berlinit nuk ka qenë një gjë aq e madhe. Ishte ajo që ishte, sinjali i fundit të Luftës së Ftohtë. Evropa qendrore rigjeti lirinë, ndërkohë që perandoria sovjetike që kish qenë perandori e carëve po zhdukej, dhe bashkë me të komunizmi



Sekretari i Përgjithshëm i OKB mund të këmbëngulë sa të dojë për fatin e rohingya-ve, mbi transferimin e ambasadës së SHBA në Jerusalem, apo dramën e migrantëve që ikin nga lufta dhe mjerimi, drejt brigjeve evropiane. Shteteve as nuk u bëhet vonë, ashtu siç nuk u bëhet vonë për borxhin e tyre publik. Nuk ka më as edhe një gjurmë hipokrizie në marrëdhëniet ndërkombëtare, asnjë "homazh që vesi i bën virtutit". Fjalët e tmerrshme që, nga Uashingtoni në Romë dhe Budapest, i quajnë imigrantët si mikroba nuk janë shumë banale sa për të tronditur. Ndryshimi nuk është vetëm politik. Po ndodh edhe një çarje kulturore me periudhën 70 vjeçare të pasluftës, kur çdo gjë që kujtonte fashizmin dhe racizmin ishte tabu. Në thelb, po zbulojmë një botë të re, e cila nuk mund të analizohet me instrumentet e vjetra.

Për një gazetar, kjo epokë nuk i përket më editorialit, por kërkimit në terren, vëzhgimit klinik të një shekulli në ngjizje. Nuk jemi domosdoshmërisht përpara kthimit të viteve tridhjetë, dhe nuk ka asnjë Hitler apo Stalin në horizont, por kaosi që po shfaqet të kujton shumë periudhën e paraluftës së 1914-ës. Këto janë arsye të përsëritshme, pas 27 viteve, rubrikën time radiofonike Géopolitique, që e kam dashur shumë, por të cilën sot dua ta zëvendësoj me një xhiro përreth botës, përmes investigimit gazetaresk dhe librave.

(France Inter)

ÇFARË NDODH PAS BETIMIT TË ERDOGANIT?

Erdogan ka përsëritur shpesh se edhe demokraci të tjera kanë sistem presidencial. Por sistemi presidencial i Turqisë ndryshon nga ai francez apo amerikan. Kështu për shembull në SHBA presidenti nuk e ka kompetencën të shpërbëjë kongresin. Erdogan mund ta bëjë këtë dhe të shpallë zgjedhje të reja. Në Francë i përcakton parlamenti anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, në Turqi përkundrazi, i merr presidenti vendimet që prekin këtë gjykatë të rëndësishme

Pasi presidenti Erdogan bëri betimin në Ankara të hënën, Turqia kalon nga sistemi parlamentar në sistemin presidencial. Të dielën me dekret ai liroi nga detyra më shumë se 18.600 nëpunës të shtetit, mes tyre 9000 policë, rreth 6000 pjesëtarë të forcave të sigurisë dhe 199 akademikë. Ky është ndoshta dekreti i fundit para heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme që pritet pas ngjitjes së tij në post.

Kanë kaluar 13 vjet që kur AKP dhe themeluesi i saj, Erdogan erdhën në pushtet. Fillimisht dukej sikur ishin vitet e demokracisë, lirisë së mendimit dhe paqes shoqërore. Por tani Turqia po i jep kompetenca të jashtëzakonshme një presidenti autoritar, me tendencë gjithnjë e më shumë islamiste dhe nacionaliste. Me shfuqizimin e funksionit kontrollues të parlamentit ai merr pushtetin e vetëm për të vendosur mbi ekzekutivin. E përmes kompetencës së përcaktimit të anëtarëve më të lartë të aparatit të drejtësisë, ai do mund të kontrollojë kështu edhe drejtësinë.

PA KRAHASIM ME SHBA DHE FRANCËN

Ersin Kalaycioglu nga Qendra Politike e Universitetit Sabancı të Stambollit thotë se nuk është ende e qartë, si do të ndryshohet sistemi. "Deri më tani sistemi i ri është diskutuar me ne vetëm në vija të trasha. As opinioni publik



dhe as studiuesit nuk i njohin detajet".

Erdogan ka përsëritur shpesh se edhe demokraci të tjera kanë sistem presidencial. Por sistemi presidencial i Turqisë ndryshon nga ai francez apo amerikan. Kështu për shembull në SHBA presidenti nuk e ka kompetencën të shpërbëjë kongresin. Erdogan mund ta bëjë këtë dhe të shpallë zgjedhje të reja. Në Francë i përcakton parlamenti anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, në Turqi përkundrazi - i merr presidenti vendimet që prekin këtë gjykatë të rëndësishme.

Studiuesja Ersin Kalaycioglu kujton tiparet autokrate të sistemit presidencial në Turqi. "Si në sistemin amerikan ashtu edhe atë francez kemi një shoqëri të mirëformuar civile. Këtë ne nuk e kemi."

Po ashtu, Erdogani në të ardhmen mund të operojë edhe me dekrete presidenciale. Deri më tani ai lejohej ta bënte këtë vetëm në kuadër të gjendjes së jashtëzakonshme. Por tani Erdogani mund ta minojë në çdo kohë juridikativën. Duket e pamundur që të funksionojë një sistem i pavarur



Në një kohë që marrëdhëniet BE-Turqi rrezikojnë të ngrijnë, një krizë tjetër është shfaqur edhe në marrëdhëniet me SHBA. Ka disa pika që i rëndojnë ato: Fetullah Gülen, që bëhet përgjegjës për puçin ushtarak nga Erdogan jeton në SHBA. Uashingtoni punon me krahun e armatosur kurd të Sirisë - YPG, por që nga Turqia shihet si organizatë terroriste. Turqia po ashtu kërkon të blejë raketa S-400 nga Rusia, megjithë anëtarësinë në NATO

dhe jo partiak i drejtësisë. Sipas politologut turk, Dogu Ergil ndarja e pushteteve dhe pavarësia e drejtësisë, kaq të rëndësishme për

demokracinë janë faktikisht të shfuqizuara me sistemin e ri.

RREZIKU ULTRANACIONALIST



Ersin Kalaycioglu nga Qendra Politike e Universitetit Sabancı të Stambollit thotë se nuk është ende e qartë, si do të ndryshohet sistemi. "Deri më tani sistemi i ri është diskutuar me ne vetëm në vija të trasha. As opinioni publik dhe as studiuesit nuk i njohin detajet"

Ende nuk dihet nëse aleanca që Erdogani mbylli me partinë nacionaliste, MHP do t'i shtojë tensionet në vend. Shumë vetë mendojnë, se qëndrimi i ashpër i MHP sidomos në çështjen kurde dhe refuzimi i disa vlerave demokratike, do të krijojë një atmosferë edhe më nacionaliste në Turqi. Erdogan ka nevojë për MHP për të siguruar shumicën në parlament. Kjo mund të kthehet në pengesën kryesore për zgjidhjen e problemit kurd dhe afrimin e Turqisë në Bashkimin Europian.

Interes të madh paraqet edhe e ardhmja e zhvillimit të marrëdhënieve me Perëndimin. Në vitin 1999 Turqia ka shtruar zyrtarisht kërkesën për anëtarësim në BE, në 3 tetor 2005 filluan negociatat. Por në 13 vitet e fundit nuk është arritur ndonjë progres për t'u shënuar. Dhe me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme para dy vjetësh, ato faktikisht janë ndaluar.

KRIZA E RE TURQI-SHBA

Kati Piri, raportuese e Parlamentit Europian për Turqinë është shprehur për një ndalimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit. Në një kohë që marrëdhëniet BE-Turqi rrezikojnë të ngrijnë, një krizë tjetër është shfaqur edhe në marrëdhëniet me SHBA. Ka disa pika që i rëndojnë ato: Fetullah Gülen, që bëhet përgjegjës për puçin ushtarak nga Erdogan jeton në SHBA. Uashingtoni punon me krahun e armatosur kurd të Sirisë - YPG, por që nga Turqia shihet si organizatë terroriste. Turqia po ashtu kërkon të blejë raketa S-400 nga Rusia, megjithë anëtarësinë në NATO. Të gjitha këto çështje i kanë futur në qorrsoak marrëdhëniet SHBA-Turqi.

Politologu Dogu Ersil i referohet edhe një sondazhi të fundit në Turqi. Sipas tij, SHBA është në Turqi më e papëlqyer se në Iran. "Në shoqëri po përhapet një qëndrim gjithnjë e më armiqësor ndaj SHBA dhe BE", thotë Ergil, pavarësisht politikës së Erdoganit.



“SHTRIGAT E NATËS” PILOTET E GUXIMSHME QË BOMBARDONIN NAZISTËT GJATË NATËS



Gjermanët i quajtën ato Nachthexen, ose “shtrigat e natës”, sepse tingulli i zhurmave të avionëve të tyre, ngjante me atë të një fshese. “Ky zë ishte paralajmërimi i vetëm që gjermanët kishin. Avionët ishin shumë të vegjël për t’u shfaqur në radar ... apo për tu kapur nga rrezet infra të kuqe”, tha Steve Prowse, autor i skenarit të filmit “The Night Witches”

Ato fluturuan nën mbulesën e errësirës dhe u ballafaquan me plumba që fluturonin në ajër, duke u ndeshur me skepticizëm dhe ngacmime seksuale në terren. Ato ishin të urryera dhe frika më e madhe e gjermanëve, aq sa çdo nazist që do të rrezonte qoftë edhe një avion ajror të drejtuar nga ato, do të nderohej automatikisht me medaljen më prestigjioze të Kryqit të Hekurt. Ato hodhën më shumë se 23.000 ton bomba mbi nazistët. Dhe duke vepruar kështu, ato u bënë forca vendimtare sovjetike për fitimin e Luftës së Dytë Botërore.

Gjermanët i quajtën ato Nachthexen, ose “shtrigat e natës”, sepse tingulli i zhurmave të avionëve të tyre, ngjante me atë të një fshese. “Ky zë ishte paralajmërimi i vetëm që gjermanët kishin. Avionët ishin shumë të vegjël për t’u shfaqur në radar ... apo për tu kapur nga rrezet infra të kuqe”, tha Steve Prowse, autor i skenarit të filmit “The Night Witches”. “Ato kurrë nuk përdornin radio, kështu që as gjumuesit e radiove nuk mund t’i dallonin. Ato ishin, në thelb, fan-

tazma”. Përdorimi i bombardueseve femra nuk ishte “plani A” i rusëve. Gratë e kishin të ndaluar të shkonin në luftë, por presioni i armikut që sa vinte dhe afrohej më shumë, iu dha udhëheqësve sovjetikë një arsye për të rishikuar këtë politikë. Adolf Hitleri kishte nisur Operacionin Barbarossa, pushtimin e tij masiv të Bashkimit Sovjetik, në qershor të vitit 1941. Deri në vjeshtë të po atij viti, gjermanët ishin bërë një kërcënim serioz ndaj Moskës, Leningradi ishte nën rrethim dhe Ushtria e Kuqe po luftonte. Sovjetikët ishin të dëshpëruar.

NJË QË GRUA KRYESON MISIONIN

Skuadronja ishte ideja e Marina Raskova, e njohur si “Amelia Earhart Sovjetike”, famëkeqe jo vetëm si pilotia e parë femër në Forcën Ajrore Sovjetike, por edhe për shumë rekorde të saj për fluturime në distanca të gjata. Ajo kishte marrë letra nga gratë anembanë Bashkimit Sovjetik që dëshironin të bashkoheshin me të në përpjekje për t’i dhënë fund

Luftës së Luftës së Dytë Botërore.

Më 8 tetor 1941, Stalini dha urdhër për vendosjen e tre njësjive të forcave ajrore të përbërë vetëm prej femrave. Gratë jo vetëm që do të fluturonin, por dhe do të hidhnin bomba, duke e bërë Bashkimin Sovjetik kombin e parë që t’u lejonte zyrtarisht grave të përfshiheshin në luftime. Më parë, gratë vetëm mund të ndihmonin në transferimin e aeroplanëve dhe municioneve.

NJË EDUKIM INTENSIV

Raskova shpejt filloi të plotësoje ekipet e saj. Prej më shumë se 2.000 aplikanteve, ajo zgjodhi rreth 400 gra për secilën prej tre njësjive. Shumica ishin studente, duke filluar nga mosha 17 deri 26 vjeç. Ato të përzgjedhurat u zhvendosën në Engels, një qytet i vogël në veri të Stalingradit, për të filluar trajnimin në Shkollën e Aviacionit Engels. Ata iu nënshtruan një edukimi intensiv. Çdo rekrute duhej të stërvitej dhe të performonte si pilote, shofere, mirëmbajtëse dhe pjesë e ekuipazhit tokësor.

Pavarësisht se ato ishin njësjia më e dekoruar e forcave ajrore sovjetike gjatë luftës, regjimenti i shtrigave të natës u shpërbë gjashtë muaj pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Dhe kur u zhvillua parada e madhe e fituesve në Moskë, ato nuk u përfshinë, sepse, u vendos, që aeroplanët e tyre ishin shumë të ngadaltë.

(bota.al)

SI U BË KOSOVA 'PARAJSE' PËR KOMPANITË SERBE?

Që nga viti 2000 e deri më sot, Kosova në mënyra të ndryshme ka qenë dhe mbetet 'parajsë' për ndërmarrjet e caktuara nga Serbia, qoftë për të tentuar që të zvogëlojnë ngarkesat e tyre tatimore, qoftë për t'i ikur tërësisht tatimeve ose pagesës së borxheve që kanë, sikurse për mallin, të cilin e paguajnë me këste.



me penale.

Duke ndjekur politikën zyrtare të Serbisë, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve u ka lejuar ndërmarrjet nga Serbia që selitë e tyre t'i bartin në adresat e qyteteve në Kosovë. Për pasojë, institucionet e Serbisë nuk kanë më asnjë mundësi që të kontrollojnë punën e këtyre sipërmarrjeve ose që t'i sanksionojnë, në rast të parregullsive gjatë të bërit biznes.

Një situatë e tillë e ka hapur rrugën për mashtrime të shumta, të cilat i kushtojnë edhe shtetit të Serbisë.

Siç ka pranuar Drejtoria Tatimore e Serbisë, disa nga ndërmarrjet, të cilat janë para-regjistruar në Kosovë, aktualisht kanë borxh ndaj shtetit të Serbisë rreth një milion euro për tatime.

Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, e cila që nga viti 2003 funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Qeverisë së Kosovës, në Kosovë janë regjistruar 339 ndërmarrje nga Serbia. Vetëm në gjysmën e parë të këtij viti janë

regjistruar 14 sosh.

Shumica e tyre, thjeshtë, po e shfrytëzon mundësinë e para-regjistrimit, në mënyrë që t'i zvogëlojnë ngarkesat e tyre, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", ekonomistja Biserka Sheqeragiq, eksperte në fushën e ekonomisë së hirtë.

"Kapitali shpërngulet aty ku ngarkesat tatimore janë më të ulëta dhe rezidentët nga Republika e Serbisë kanë filluar t'i para-regjistrojnë ndërmarrjet që nga viti 2010. Kjo nuk është asgjë e re, vetëm se tash është bërë e dukshme", ka thënë Sheqeragiq.

Për ta shpjeguar në mënyrë më precize, ajo shërbehet me përllorëgaritjen e ngarkesës tatimore të fitimit në Serbi dhe në Kosovë.

"Kam marrë minimalen bazike të punës nga prilli i vitit 2013, e cila është në shumën 192 euro. Në këtë fitim, ngarkesa në emër të tatimit dhe kontributit, në Serbi është 109.3 euro. Pra, 56, 3 për qind. Në të njëjtën bazë, (pra, 192 euro), në Kosovë, ngarkesat tatimore janë 26.88 euro ose 14 për qind. Praktiki-

sht, kjo do të thotë se mjetet e ndarra nga puna e të punësuarve në Serbi është më e madhe për tre herë, në krahasim me të njëjtat në Kosovë", ka thënë i Sheqeragiq.

Megjithatë, fenomen shumë më serioz është çështja ndërmarrjeve, të cilat mundësinë e bartjes së selive në adresat në Kosovë po e keqpërdorin në mënyra të ndryshme të mashtrimeve. Për këtë qëllim, ndërmarrjet shpërngulen edhe në veri të Kosovës, që është i banuar me shumicë serbe dhe i cili që nga nënshkrimi i marrëveshjes së Brukselit, gjendet në një periudhë tranzicioni të integritimit në sistemin e Kosovës, por edhe në pjesën ku autoritetet e Kosovës pa ndonjë problem i zbatojnë ligjet e Kosovës, sikurse në Prishtinë.

Portali "Insajder.net", për dy vjet ka hulumtuar këtë lloj të keqpërdorimit, të shmangies së pagesës së obligimeve dhe shkaktimin të dëmit ndaj shtetit dhe ndërmarrjeve tjera. Ky portal ka zbuluar se në vetëm 3 adresa në Prishtinë, gjatë disa viteve të fundit, nga Serbia janë para-regjistruar madje 80 ndërmarrje.

"Disa ndërmarrje që i kemi përcjellë dhe më vonë i kemi regjistruar adresat në të cilat ato janë të lajmëruara në Prishtinë, praktikisht janë 'ndërmarrje fantome'. Ato, kur e kryejnë mashtrimin thjeshtë, më nuk ekzistojnë", ka thënë Jelena Jankoviq, gazetare e portalit "Insajder.net".

Mashtrimet që bëhet me shpërnguljen e ndërmarrjeve në Kosovë, duke iu ikur tatimeve dhe pagesave të borxheve, nuk e befa-

sojnë kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërçhalii.

Sipas tij, kur bëhet fjalë për evazionin fiskal, kryesisht ka të bëjë me veriun e Kosovës, duke e quajtur atë si "vrime e zezë" më e madhe ekonomike në Ballkan. Për ilustrim, ai citon të dhënën se në veri ende nuk kanë arritur arkat fiskale, ndonëse procesi i fiskalizimit kishte nisur në vitin 2010.

Se shteti i Serbisë është i vetëdijshëm për këtë problem, dëshmon edhe fakti se në qershor të vitit 2017, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kishte folur për transmetuesin publik serb lidhur me atë se si po i identifikojnë të ashtuquajturat "ndërmarrje fantome" në Kosovë.

Megjithatë, mbetet e paqartë se çfarë mund të bëjë shteti serb më tutje, marrë parasysh që personat përgjegjës që janë në Kosovë, nuk janë të qasshëm nga organet e Serbisë. Përgjigja që organet kompetente të Serbisë kanë dhënë lidhur me këtë çështje, kryesisht mund të rrrumbullakohet në "varësisht nga rrethanat objektive në terren", thekson gazetaria e "Insajder-it", Jelena Jankoviq.

Njëkohësisht, nga Drejtoria për taksat e Serbisë, ka thënë se që nga viti 2010 e deri më sot janë paraqitur mbi 100 kallëzime penale kundër personave përgjegjës, të cilët tash i kanë selitë në territorin e Kosovës. Procedurat janë nisur pranë gjykatave në Serbi, por mbetet e paqartë se si do të zbatoheshin aktvendimet në qoftë se ato sillen, marrë parasysh që përmbauesit nuk kanë kompetenca në Kosovë.

LIBERALIZMI I VIZAVE, A KA SKEPTICIZËM BRENDIA BE-së?

Fillimisht nga Brukseli ishte premtuar që nga fundi i qershorit apo fillimi i korrikut Komisioni Evropian të dalë me rekomandimin për liberalizimin e vizave dhe rreth kritereve të përmbushura. Ndër kriteret kyçe është ai i dëshmimeve se Kosova po e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin

Prishtinë, 10 korrik - Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës presin rekomandim pozitiv nga Komisioni Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave, pavarësisht se rekomandimi për këtë proces tashmë

është pritur të ndodhë.

Mospublikimi i rekomandimit nga Brukseli, në Prishtinë më shumë po shihet si procedurë që ndërlidhet me Bashkimin Evropian.

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rekomandimi pritet të dalë shpejtë, pasi siç thotë ajo, kështu u është thënë nga zyrtarët në Bruksel. Megjithatë, ajo ka shtuar se tanimë kjo është një çështje që mbetet në duart e institucioneve të BE-së, derisa Kosova ka punuar në plotësimin e kritereve.

Ndërkaq, analistët politikë, njohës të procesit integruar evropian, kanë thënë se rekomandimi mund të jetë pozitiv, por ka pak gjasa që Kosova sivjet të përfshihet në kuadër të zonës së lëvizjes së lirë, pa viza.

Taulant Kryeziu, njohës i çështjeve të integritimit evropian duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se ka disa zhvillime të cilat



mund t'ia vështirësojnë Kosovës marrjen e liberalizimit të vizave gjatë këtij viti.

Sipas tij, Kosova nuk ka shënuar progres në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit lartë. Ndërkaq edhe brenda BE-së, sipas Kryeziut, ka një mjedisin jashtëzakonisht negativ politik për çështje të migrimit.

Në anën tjetër edhe Blerta Delli-Kodra, kryetare e Komisionit për Integritim Evropian në Kuvendin e Kosovës, ka thënë se Kosova ka

përmbushur kriteret që qytetarët e saj të lëvizin lirshëm pa viza në shtetet e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Komisionit Evropian dhe institucioneve tjera të Bashkimit Evropian iu mbetet të marrin masa dhe të veprojnë konform këtij rekomandimi.

Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se në aspektin institucional, Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret, por ai ka potencuar faktin se shihet skepticizëm brenda vet Bashkimit Evropian. "Kjo ka qenë arsyeja pse

kam ndërmarrë hapat për vizita. Skepticizmi brenda vet Bashkimit Evropian vjen për shkak të situatës e cila është në rend të parë tanimë publike: mosmarrëveshjet të cilat janë brenda BE-së mbi formën e zgjerimit të BE-së dhe funksionit të vet Bashkimit Evropian", ka deklaruar Veseli.

Fillimisht nga Brukseli ishte premtuar që nga fundi i qershorit apo fillimi i korrikut Komisioni Evropian të dalë me rekomandimin për liberalizimin e vizave dhe rreth kritereve të përmbushura. Ndër kriteret kyçe është ai i dëshmimeve se Kosova po e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin. Nëse organet e BE-së rikonfirmojnë vullnetin e tyre për liberalizim të vizave, më pas u mbetet edhe vendeve anëtare të BE-së që të japin vendimet e tyre. Pritjet nga institucionet e Kosovës janë që këto procedura në BE të përmbillen deri në fund të këtij viti.

(Epoka e Re)

E ARDHMJA E EUROPËS SIPAS CIA

SI DO TË JENË SERBIA E SHQIPËRIA?

Projeksioni i CIA deri në vitin 2020 parashikon krjimin e bllokut perendimor, ose "Europën e vjetër", pastaj "Europën e re" dhe "Europën ortodokse"

Shkup, 10 korrik - Bashkimi Europian, çfarë e shohim sot, shumë shpejt mund t'i takojë së kaluarës. Agjensia Ameriakne e Zbulimit (CIA) ardhmërinë e kontinentit të vjetër e sheh në një përbërje krejt të re – të ndarë në tri pjesë – në Europën e "re", "të vjetër" dhe "ortodokse", në të cilën do të përfshihet edhe Serbia, shkruan gazeta beogradase "Novosti".

Njëkohësisht edhe agjensia "Stratfort" parashikon ndryshime radikale – fuqizimin e Polonisë dhe Rumanisë përmes partneriteit strategjikë me SHBA,



ngritjen e Turqisë si fuqi rajonale dhe si kundërpeshë e Iranit në dëm të zvoglimit të ndikimit gjerman në Europë, transmeton gazeta KOHA.

Projeksioni i CIA deri në vitin 2020 parashikon krjimin e bllokut perendimor, ose "Europën e vjetër" e cila do të përbehet nga Gjermania, Franca, Austria, Britania e Madhe, Spanja, Portugalia, Italia, Suedia, Norvegjia, Finlanda, pastaj "Europën e re" – Letonia, Lituania, Estonija, Polonia, Hungaria, Çekia, Sllovakia, Sllovenia dhe Kroacia, vende këto të cilat dikur ishin shtylla e Paktit të Varshavës, në të ardhmen do të jenë mbështetësit

kryesor ushtrakë të Amerikës në Europë, shkruan "Novosti".

Sipas gazetës beogradase, CIA qysh para dhjetë viteve kishte parashikuar se Europa do të ndodhet në një krizë të thellë, me çka hyrja e shteteve ballkanike në BE nuk do të mund të bëhet. Qysh atëherë parashihej që Serbia, bashkë me vendet tjera ballkanike, Greqinë, Bullgarinë, Maqedoninë, Rumaninë, do të jenë në grupin e "vendeve ortodokse". Këtij grupi gjoja do ti takojë edhe Shqipëria me BeH, transmeton gazeta KOHA.

"Në dekadën e ardhshme Europa do të ridefinohet me ngritjen e shteteve nacionale, si

fuqi lëvizëzë në kontinent. Numri i shteteve nacionale do të rritet gjatë lëvizjeve secesioniste apo shkatërrimit të shteteve të caktuara", nënvizon "Stratfort" në projektionin e bërë për të ardhmen e Europës deri në vitin 2025, shkruan "Novosti".

Në këto parashikime të CIA hyn edhe situatë demografike e Europës. Sipas këtyre parashikimeve në dhjetë vitet erdshme pritet të ketë rritje të popullatës muslimane në Europë nga 22 në 33 për qind.

Gjithashtu edhe marrëdhëniet në mes të BE-së dhe SHBA janë objekt trajtimi i këtyre analizave dhe, sipas gazetës beogradase e cila citon burime të CIA-s, parashikohet largimi i SHBA nga disa "institucione të përbashkëta" me traditë që nga Lufta e Dytë Botërore, kurse NATO do të mund të dobësohet dhe të zëvendësohet me një arkitekturë të re europiane në fushën e mbrojtjes, transmeton gazeta KOHA.



Erdogan e rikonfirmon dhëndrin ministër

Pas ceremonisë zyrtare të betimit në Parlament, Erdogan zhvilloi homazhe në mauzoleumin e themeluesit të Turqisë moderne dhe laike, Qemal Atatürk, mbase për të qetësuar zërat kritikë që e akuzojnë jo vetëm për shndërrimi në sultan, por edhe për islamizimin e Turqisë. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e ka emëruar dhëndrin e tij në postin e ministrit të Thesarit dhe Financave në kabinetin e ri qeveritar, të hënën, duke e zbritur vlerën e lirës turke dhe me gjasë duke thelluar shqetësimet për pavarësinë e bankës qendrore, raporton Reuters.

Në një ceremoni në Ankara pak orë pasi dha betimin për mandatin e ri presidencial, Erdogani emëroi ministrat e rinj të kabinetit duke ia dhënë dhëndrit të tij, Berat Albayrak këtë post të rëndësishëm qeveritar. Zgjedhja e Albayrak, i cili u martua me vajzën e Erdoganit në vitin 2004, me gjasë nuk do të mirëpritet nga investitorët e huaj të cilët janë të shqetësuar për shëndetin e ekonomisë turke, raporton Financial Times.

Në kabinetin e ri qeveritar të Presidenti Recep Tayyip Erdogan kanë hyrë edhe Abdulhamit Gul emërohet ministër i Drejtësisë. Murat Kurum emërohet Ministër i Mjedisit dhe Urbanizmit në kabinetin e ri në Turqi, ndërsa Mevlut Çavusoglu ministër i Jashtëm. Ministër i Arsimit emërohet Ziya Selçuk, ministër i Mbrojtjes Hulusi Akar, ndërsa ministër i Shëndetësisë Fahrettin Koca.

Që nga kjo e hënë, Turqia ka një sistem të ri qeverisës, ku presidenti ka fuqi të jashtëzakonshme. Erdogan u betua në Parlament një muaj pas zgjedhjeve që i fitoi me 53% të votave, e që ligjëruan fuqitë e reja për të, që i japin fund qeverisjes së Parlamentit dhe shndërrojnë presidentin në një sultan, siç është cilësuar nga kritikët. "Si president, betohem për nderin tim para kombit dhe historisë madhështore turke, se do të punoj me të gjitha energjitë e mia që të mbroj dhe lartësoj lavdinë dhe nderin e Republikës së Turqisë", tha Erdogan.

Sistemi i ri presidencial i Turqisë eliminon kryeministrin, e tashmë është presidenti që formon qeverinë, duke emëruar zëvendësit e tij dhe ministrat, nxjerr dekrete, përgatit buxhetin dhe vendos politikat e sigurisë. Sipas sistemit të ri, Erdogan, jo vetëm që do të drejtojë ekzekutivin, por edhe partinë e tij në Parlament, diçka që kritikën thonë se është ligjërimit i sundimit të një njeriu. Mbase për këtë arsye, opozita në Parlament as që u ngrit në këmbë gjatë betimit të Erdoganit, siç është zakon, ndërsa kreu i Partisë Popullore Republikane, Kemal Kilçdaroglu, as që ishte në sallë. Pas ceremonisë zyrtare të betimit në Parlament, Erdogan zhvilloi homazhe në mauzoleumin e themeluesit të Turqisë moderne dhe laike, Qemal Atatürk, mbase për të qetësuar zërat kritikë që e akuzojnë jo vetëm për shndërrimi në sultan, por edhe për islamizimin e Turqisë.

Drejtuesit e NATO-s u mblodhën këtë javë në një takim që synonte dhënien e përgjigjeve më të forta ndaj kërcënimeve globale. Por kriza më e madhe mund të ketë të bëjë me pikëpamjet e ndryshme midis Trumpit dhe Gjermanisë.

Presidenti amerikan tha javën e kaluar në fjalimin e mbajtur në Montana se do të shkojë në takim, "për t' i thënë NATO-s: 'Ju duhet të filloni të paguani faturat tuaja. Shtetet e Bashkuara nuk do të kujdesen për çdo gjë!' Masa e njerëzve shpërtheu në duartrokitje kur Trump iu kthye temës së preferuar: shpenzimeve të ulta të Gjermanisë për çështjet e mbrojtjes dhe kryesueses së saj, kancelares Angela Merkel. Trump tha se "i ka thënë Angelës" se "ai nuk mund garantojë mbrojtjen e mëtejshme dhe... nuk e di sa e mbrojmë ne veten duke ju mbrojtur juve."

Kjo godet një nga rregullat fundamentale të aleancës ushtarake, të shprehur në artikullin V të saj, për mbrojtjen e ndërsjellë të njeri tjetrit dhe rrezikon shpresat e NATO-s për të organizuar një samit të dirigjuar mirë më 11 dhe 12 korrik, ditën e inagurimit të selisë së re. Ajo që mund të quhet "sukses" sot është të mos ketë dështim diplomatik si ai që ndodhi në takimin e G7 në fillim

PËRGJIGJET E NATOS NDAJ KËRCËNIMEVE GLOBALE

KRIZA MË E MADHE - PIKËPAMJET E NDRYSHME MIDIS TRUMPIT DHE GJERMANISË

të qershorit, ku Trump refuzoi të firmoste deklaratën përfundimtare, e quajti kryeministrin kanadez Justin Trudeau "të pasinqertë" dhe u kap në një fotografi që u shpërnda menjëherë në rrjetet sociale, fotografi në të cilën dukej duke këmbyer vështrime të ashpra me kancelaren gjermane.

"Ne kemi të drejtë të jemi të nervozuar", thotë Sophia Besch, nga qendra Centre for European Reform (CER), lidhur me mundësinë që përplasjet Merkel-Trump të prishin samitin. "Trump ka vënë 2 përqindshin si nivelin që çdo udhëheqës evropian të marrë bekimin e tij, prandaj të gjithë janë të shqetësuar." Vetëm 7 vende aleate përveç SHBA investojnë tek ushtritë e tyre në nivelin e dëshiruar, ndërsa 29 vendet e tjera janë duke e rritur tani buxhetin e mbrojtjes, një tendencë që filloi në vitin 2014.

'SHERRET E NATO-S ÇOJNË UJË NË MULLIRIN E PUTINIT'

Ndërkohë që i ka dërguar letra shumë aleatëve duke i paralajmëruar se shpenzimet e tyre ushtarake nuk janë të kënaqshme, pakënaqësitë e Trumpit pritet të drejtohen kryesisht kundër Merkelit, e cila drejton ekonominë më të madhe të Evropës, duke dhënë vetëm 1,2 përqind të



prodhimit të përgjithshëm bruto për mbrojtjen, me një plan që tarrisë këtë në 1,5 përqind në vitin 2025.

Megjithëse është dakord se Gjermania duhet të rrisë më shumë shpenzimet e mbrojtjes, Besch mendon se retorika e pafund e Trumpit është kundërproduktive dhe madje e rrezikshme. "Çdo gjë që minon aleancën transatlantike shkon në favor të presidentit rus, Vladimir Putin", i thotë ajo DW. "Mënyra se presidenti Trump veçon Angela Merkelin dhe ndan potencialisht evropianët".

AGJITACIONI NË REND TË DITËS

Por James Appathurai, zëvendës asistent i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, për çështjet politike dhe politikat e sigurisë, shpjegon se aleanca nuk mund t' i bjerë shkurt diskutime-

ve për "paratë, aftësitë dhe kontributet". Është shumë e rëndësishme që ne të mos përfundojmë në një situatë ku Shtetet e Bashkuara të irritohen aq shumë sa t'u krijohet përshtypja se duhet të marrin vendime të tjera". Kjo do kishte pasoja të tmerrshme për të gjithë. Ajo që duhet të bëjmë ne është që të tregojmë se ngarkesat janë ndarë në mënyrë të drejtë në kurriz të të gjithëve". Trump ka sugjeruar tashmë se mund të largojë nga Gjermania 35 mijë ushtarë të personelit të stacionuar aty. Ka edhe shumë tema të tjera që kërkojnë kujdes, si përgjigje e unifikuar ndaj agresionit rus është një nga më të qartat. Shqetësimet e reja janë krijuar nga përgjigja joroduktive e Trumpit për çështjen e aneksimit rus të rajonit ukrainas të Krimesë, një nga ngjarjet më transformuese në historinë e NATO-s së pas Luftës së ftohtë./DW/

ZARIE TELHA. NGA KATRAHURA E VENDLINDJES NË BALLË TË DEMONSTRATAVE SHQIPTARO-AMERIKANE

Babanë e dërguan në burg. Pas tri ditësh ishte festa e Bajrami të Vogël. Vjen në shtëpi një ushtar me pushkë dhe i thotë gjyshes që të shkonte ta marrë djalin prej burgu, se kishte vdekur, gjoja se kishte bërë vetëvrasje. Të gjithë burrat e farefisit ishin të mbyllur në Monopol. Nuk kishte kush të shkonte që ta marrë babanë nga burgu të vdekur

Nga Ismail ARSLLANI

Aeroplani tejoqeanik gllabëronte mijëra kilometra për të zbritur në Aeroportin e Shkupit, ku do të përfundonte destinacioni i zonjës Zarie Telha, një veprimtare dhe atdhetare e pashoqe, tashmë në moshë të thyer, me jetesë në Çikago të Amerikës, e larguar më se 60 vjet më parë nga vendlindja - Tetova, të cilën e braktisi bashkë me familjen, pas një presioni të madh të pushtetit komunist, për t'u shpërngulur në Turqi, prej nga më vonë do të shkojë në kontinentin e premtimeve të mëdha.

Ajo mban në zemër kujtime të hidhura nga vendlindja, ku komunistët partizanë gjatë ditëve të arrestimeve të mëdha të shqiptarëve që u mbyllën në Monopolin e Tetovës, nga fundi i nëntorit të vitit 1944, rrahën brutalisht të parët e saj dhe ia vranë babanë, Servetin, në burgun e Tetovës. Kujtimet radhiten në shiritin e memories, për krahurën që kishte përjetuar si fëmijë në vendlindje, të cilën e donte aq shumë. Vetën e krahason me bilbilin që doli nga "kafazi i artë", për t'u kthyer për pak çaste në ferrat dhe shkurret e vendlindjes.

"Sa herë që vij në Tetovë nga Amerika e largët, më përtëriten plagët e së kaluarës, kur pushteti i



ri komunist pas Luftës së Dytë Botërore, ma mbyti pa kurrfarë faji dhe pa gjykim babanë tim, Servetin, në burgun e Tetovës. Ishte kohë e vështirë. Sapo kishin hyrë partizanët në qytet, kishin filluar me arrestime të mëdha të burrave shqiptarë, të cilët i mbyllën në Monopolin e Tetovës, për hakmarrje. Gjatë kohës së Shqipërisë, në Tetovë kishte ndodhur një vrasje të një qytetari maqedonas, ndërsa për këtë dyshonin te xhaxhai im, Refeti. Meqë ai ishte arratisur më herët, zunë babanë tim që ta marrin nën hetime. Ishin pikërisht maqedonasit nga Llaca, të cilët në kohën e Shqipërisë (1941-1944) i ruante babai nga haj-

dutët, e zunë dhe të lidhur ua dorëzuan ushtarëve partizanë", kujtohet sot znj. Zarie, për ato ditë dramatike në familjen e saj, e cila, asokohe, në moshë minore, nuk mund të kuptonte se ç'po ndodh.

VENDLINDJA, NJË PLAGË E PASHËRUAR

Shtëpia e zonjës Zarie ishte përballë Policisë së Tetovës. Menjëherë pas ardhjes së partizanëve, ishin sulur ish-pronarët e shtëpisë ku jetonte familja e Zaries, me kërcënime e shantazhe që të dalin nga shtëpia, sepse ajo qenqesh e atyre dhe se gjoja këta nuk e kishin paguar. Nga frika për të mos ndodh më e keqja, familja

e Zaries braktis shtëpinë dhe përkohësisht strehohet te halla, në lagjen e Klikovës.

"Jo vetëm që humbëm babanë, por shumë shpejt mbetëm edhe pa kulm mbi kokë. Na nxorën me forcë nga shtëpia dhe mbetëm nën qiell të hapur. U dyndëm andej-këndej, derisa nuk gjetëm një zgjidhje. Si ndodhi kjo? Një muaj pas vdekjes së babait, erdhi maqedonasi nga i cili e kishim blerë shtëpinë. Ai i kishte thënë gjyshes se, djali i saj, Serveti, nuk e kishte paguar shtëpinë, ndaj dhe pas kërcënimeve, nga frika braktisëm atë, ku jetonim bashkë me gjyshen, nënën dhe vëllanë. Ne shkuam te halla, ku mbetëm nja

dy vjet, pastaj dolëm në një objekt tjetër banimi afër xhamisë së Gamgamit, i cili kishte qenë një medrese. Aty kemi ndenjur disa vite, derisa shkuam në Turqi, në vitet e 50-ta, kur u hap rruga për shpërngulje. Ndërsa xhaxhallarët, të cilët u arratisën në mal, më vonë u paraqitën nga Greqia, ndërkohë që njëri prej tyre, Refeti, iku për në Turqi, ndërsa Nuhiu u vra në kufi për në Shqipëri", shpjegon me dhembje në shpirt, znj. Zarie, këtë episod të jetës së saj.

SI NDODHI TRAGJEDIA?

Pas Luftës së Dytë Botërore, thanë që erdhi liria dhe barazia. Njerëzit besuan. Por nuk ishte kështu. "Vetëm tri ditë pas ardhjes së pushtetit të ri komunist, erdhën disa ushtarë në shtëpinë tonë, ku ishin strehuar xhaxhai im, Nuhiu dhe kushëriri Raufi, të cilët i rrahën keq, derisa u lodhën. Rrahën edhe gjyshen time dhe pastaj u larguan. Ata asgjë nuk kërkonin prej nesh, por vetëm na rrihnin. Kushëriri Raufi ia bënë fytyrën me gjak, dhe në atë gjendje e dërguan në burg", përshkruan znj. Zarie tragjedinë që ndodhi në familje.

Pas tri ditësh, derisa Zarija e vogël luante në rrugë, kishte parë disa ushtarë e civilë që e sillnin babanë e saj të lidhur dhe në gjendje të rraskapitur. E kishin futur në shtëpi dhe ia kishin zgjidhur duart. Kishin ofruar një cigare, gjoja për qetësim. Por, në moment ishin kërcënuar ndaj gjyshes së saj, duke e goditur me grushte dhe duke e përplasur në skaj të dhomës. Atëherë kishte reaguuar babai i saj, Serveti, duke u thënë ushtarëve se ishte dorëzuar që ta mbrojë familjen nga dhuna dhe jo ta rrihnin para syve nënën e tij. Ata përsëri ia lidhën duart Servetit dhe i kishin thënë që t'i përqaftonte njerëzit e shtëpisë, sepse nuk do t'i shihte më. Babai i Zarijes i kishte përqaftuar fëmijët dhe nënën e vet, kurse ata i kishin thënë që ta përqaftonte edhe gjuan. Ai u kishte thënë që shqiptarët nuk e kanë këtë zakon. Por ata e kishin detyruar dhe ky i kishte thënë në vesh gruas, që mos t'i lëshonte nga dora fëmijët.

"Babanë e dërguan në burg. Pas tri ditësh ishte festa e Bajrami të Vogël. Vjen në shtëpi një ushtar me pushkë dhe i thotë gjyshes që të shkonte ta marrë djalin prej burgu, se kishte vdekur, gjoja se kish-





ishin njerëz të vranë në shpirt. Kishin program të posaçëm, ku znj. Zarie i angazhonte edhe vajzat e saj që ishin lindur në Amerikë, por flisnin bukur në gjuhën amtare. Gjatë festave, ato recitonin në shqip. Një vit, ajo kishte vendosur që të dhurojë një flamur kombëtar, me shqiponjën dykrerësh, të qëndisur nga dora e saj. Punoi me zell e durim për gjashtë muaj dhe atë e dhuroi gjatë një feste kombëtare. Gjatë veprimtarisë së saj atdhetare në Amerikë, çdo herë ishte pranë patriotit të shquar Jusuf Azemi, kryetarin e Ballit Kombëtar në Amerikë (që më vonë u bashkua me Lidhjen Kosovare), të cilin e kishte djalë tezeje. Çdo gjë organizohej në koordinim me të. Në demonstratat shqiptaro-amerikane merrnin pjesë edhe zyrtarë amerikanë, por edhe personalitete të tjera të rëndësishme, si Agim Sylja nga Shqipëria, babai i të cilit ka qenë një zyrtar i lartë në Tetovë, gjatë kohës së Shqipërisë, Ismail Kashtanjeva e të tjerë.

“Derisa isha në Turqi, takohesha me Qazim Prodanin, i cili botoi gazetën ‘BESA’ në gjuhën shqipe. Pastaj, në kongresin që patëm në Amerikë ishin të pranishëm edhe Vasil Andoni, Abaz Ermeni etj. Ata qëndruan në shtëpinë time. Me atë rast patëm organizuar një program të pasur, me recitime vjershash patriotike. Vajza ime e madhe drejtonte programin. Recitali që titullohej: ‘Oj hënë, pse nuk dole?’, ishte përgatitur enkas për këtë manifestim nga bashkëshortja e veprimtarit tonë të njohur në Amerikë, Abdylsami Xhaferi. Organizuam edhe një ‘skeç’ simbolik për hedhjen e prangave të robërisë. Vajzës sime të vogël ia lidhëm duart me zinxhirë dhe me dry dhe ashtu të ‘robëruar’ e çuam te Abaz Ermeni, që t’ia zgjidhte, me simbolikën që të zgjidheshin nga prangat e më herëshme Shqipëria dhe Kosova, përdërisa ajo nxori nga gjoksi një flamur të vogël kuqezi, për t’ia dorëzuar atij. Mësuam më vonë se ai e mbajti atë flamur deri në fund të jetës së tij”. Zonja Zarie flet me admirim për fshatin Dobrosht, nga e ka rrënjët familja e saj, si për një vendbanim të transformuar në “Paris të vogël” dhe për Tetovën e saj, ku e kaloi moshën më të brishtë e të përvuajtur.

“Kur erdha në Tetovë me burrin, për herë të parë pas 17 vjetësh, nuk pashë ndryshime të mëdha, por më vonë kur qëndrova me vajzën, sidomos gjatë ardhjes së fundit, në qershor të këtij viti, pashë një qytet me ndryshime të mëdha bashkëkohore dhe zemra m’u bë mal. Me këtë rast vizitova Universitetin e Tetovës dhe mbeta e mahnitur nga përparimi që kishin arritur bashkëvendësit e mi. Vizitova edhe shkollën fillore ‘Naim Frashëri’ në Tetovë dhe kam mbetur pa fjalë kur kam dëgjuar nga nxënësit se sa bukur e flisnin anglishten”, përfundon rrëfimin e saj znj. Zarie, përplot me mallëngjim për vendlindjen.

te bërë vetëvrasje. Të gjithë burrat e farefisit ishin të mbyllur në Monopol. Nuk kishte kush të shkonte që ta marrë babanë nga burgu të vdekur. Në shtëpinë tonë ishte për fat vetëm një kushëri prej Dobroshti, prej nga e kemi prejardhjen. Kështu bashkë me gjyshen shkuan në burg dhe e sollën babanë të vdekur, duke mbajtur me një lesë. S’kishim njerëz për ta varrosur babanë. Gjyshja shkoi shtëpi më shtëpi të gjejë ndonjë burrë. Kështu e gjeti Ibrahim Tërshanën, i cili erdhi me djemtë e tij. Përgatitën kufomën dhe e çuan ta varrosin, por ne nuk e dinim se ku e kanë varrosur, as atëherë e as sot. Sa herë që kam ardhur në Tetovë, e kam vizituar Teqenë e Tetovës, me shpresë se aty do ta gjeja varrin”, kujton ato ditë të hidhura, znj. Zarie.

SHPËTIMI NË TURQI

“Kur shkuam në Turqi, u gëzua shumë, sepse ikëm nga rreziku që na kanosej nga shteti. Në Turqi mbetëm 5 vjet. Shqiptarët që ishin shpërngulur në Amerikë, vinin në Turqi dhe aty martoheshin me shqiptare. Kështu u martova edhe unë, me burrin që erdhi nga Amerika në Turqi, në vitin 1961. Në Amerikë mora edhe nënën, vëllezërit, ndërsa xhaxhai kishte

vdekur. Pas shumë vitesh prapë mbeta vetë, sepse më vdiq vëllai dhe vajza. Në Amerikë e kam bartur gjithë atë mllef që kisha akumuluar në vendlindje nga pushteti i egër dhe anti-shqiptar, ndaj dhe kam pasur shtytje dhe motivim të vazhdueshëm për të punuar për çështjen shqiptare dhe për të drejtat e tyre legjitime në viset shqiptare”, përshkruan znj. Zarie momentet e shkuarjes dhe veprimtarisë së vet në Amerikë

Ajo flet me shumë emocione për jetën dhe veprimtarinë e saj patriotike në Amerikën e largët. Tregon disa foto nga një protestë në Ditën e Kombeve të Robëruara, ku ajo është me veshje kombëtare.

“Flamurin shqiptar e kam parë për herë të parë në Amerikë. Dhjetë vjet me radhë kam dalë në demonstratat shqiptaro-amerikane, bashkë me dy vajzat e mia, me pankarta që kishin përmbajtje për liri e demokraci, për të drejta dhe barazi të shqiptarëve në trojet e ish-Jugosllavisë. Në fillim, kur hyra në Amerikë, nuk kishte shumë familje shqiptare, ndaj dhe në demonstrata nuk kishte mjaft femra. Isha unë dhe një zonjë prej Kosove”, rrëfen më tej znj. Zarie, për përjetimet e saj në Amerikë.

Festat e flamurit i organizonin në mënyrë madhështore, sepse



AJO QË MENDOHEJ SE ISHTE PARAROJA E HISTORISË, DOLI VETËM NJË RRUGË PA KRYE

Ngjarjet në shumicën e vendeve të Europës Lindore ishin më të papritura dhe dramatike. Në tetor të vitit 1989 në Gjermaninë Lindore u zhvilluan demonstrata masive në rrugë dhe Muri i Berlinit u rrëzua në nëntor të po atij viti. Menjëherë pas kësaj, ngjarje të tilla ndodhën edhe në Çekosllovakia, që çuan në “revolucionin paqësor”. Vetëm në Rumani pati dhunë të konsiderueshme nga të dyja palët

Nga Anthony GIDDENS

Shumica e revolucioneve që kanë ndodhur në shekullin e 20-të janë shoqëruar me marksizmin dhe me ardhjen në pushtet të partive komuniste. Sipas Marksit, shoqëria komuniste formon një fazë të zhvillimit të shoqërisë pas kapitalizmit dhe besohej shteti njëpartiak i vendosur në Bashkimin Sovjetik, në Kinë dhe në një numër vendesh të Europës Lindore shënonte një përparim mbi atë të demokracisë liberale të stilit perëndimor.

Kina, vendi me popullsi më të madhe në botë, ka mbetur komuniste, ka pak kohë që ka rifitur në ekonominë e saj mekanizmat e tregut. Sidoqoftë Bashkimi Sovjetik nuk ekziston më dhe në Europën Lindore nuk ka mbetur asnjë shtet komunist. Ç’rrethanë e rastësishme! Sepse ajo që supozohej të ishte pararoja e historisë, doli se ishte më tepër një rrugë pa krye. Në vend që të çonin më tej kauzën e marksizmit dhe komunizmit, revolucionet e viti 1989 në Europën lindore e rrënuan atë. Në vend që të kapërcenin kapitalizmin, ato synuan dhe arritën rivendosjen e tij. Në vend që të përparonin tej demokracisë liberale shumëpartiake, ato ishin të interesuara në vendosjen e saj.

Ndonëse në mënyrë më pak dramatike, Revolucioni Rus i viti 1917 është përmbysuar. Ai që dukej se ishte një sistem i konsoliduar mirë, madje i pazëvendësueshëm, me gjithë natyrën e tij shtypëse, u shua brenda nja hapësire kohore 2-vjeçare, megjithëse një proces reformash të brendshme kishte filluar më përpara. Deri në fund të viteve 1980, Bashkimi Sovjetik konsiderohej së bashku me SHBA-në si një ndër dy “superfuqitë” e botës. Që nga 1992, në vend që të ishte superfuqi, ai u nda në shtete të veçanta nga të cilat vetëm dy, Rusia dhe Ukraina, mund të pretendojnë të jenë midis kombeve më të fuqishme të botës.

Çfarë i shpjegon këto ngjarje? A duhet të konsiderohen ndryshimet që ndodhën në Europën Lindore në vitin 1989 si revolucione të vërteta? Apo kemi të bëjmë me një formë proteste që ka vetëm vlera historike? Ngjarjet në shumicën e vendeve të Europës Lindore ishin më të papritura dhe dramatike. Në tetor të vitit 1989 në Gjermaninë Lindore u zhvilluan demonstrata masive në rrugë dhe Muri i Berlinit u rrëzua në nëntor të po atij viti. Menjëherë pas kësaj, ngjarje të tilla ndodhën edhe në Çekosllovakia, që çuan në “revolucionin paqësor”. Vetëm në Rumani pati dhunë të konsiderueshme nga të dyja palët. Në dhjetor të 1989-s, udhëheqësi komunisti Nikolea Çauseshku u ekzekutua së bashku me gruan e tij.

“RRËNJËT SHQIPTARE-DHEU DANEZ”

FILMI DOKUMENTAR PËR SHQIPTARËT NË DANIMARKË

“Rrënjët shqiptare-dheu danez”, filmi dokumentar për shqiptarët që jetojnë dhe punojnë në Danimarkë, do të shfaqet në 22 korrik në Prizren.

Regjizori Ixhet Lutfiu, me bashkëpunëtorët e tij, ka zgjedhur qytetin e Prizrenit që më 22 korrik 2018 (ora 20.30) të promovoj filmin e tij më të ri dokumentar “Rrënjët shqiptare – dheu danez”, kush-tuar shqiptarëve që jetojnë e veprojnë në Danimarkë. Ixhet Lutfiu duke qenë pjesë e ekipit të radio televizionit “Zëri i Kosovës” që nga viti 1991 ka arritur të grumbullojë materialin e nevojshëm dhe të shfrytëzoj në mënyrë profesionale arkivin e këtij mediumi të rëndësishëm kombëtar.

Dokumentari përshkruan kronologjikisht (që nga viti 1965) veprimtarinë historike dhe kulturore të shqiptarëve të Danimarkës dhe është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë, që po promovohet tani, përfshin vitet 1965-1999 dhe trajton mbi 20 tema, kurse pjesa e dytë që përfshin vitet 2000-2018 trajton rreth 40 tema të fu-



shave të ndryshme si psh arsimit, kultura, sporti e muzika.

Shqiptarët e Danimarkës që nën flamurin danez prekën majat e suksesit edhe në arenën ndërkombëtare llogariten si të mirëintegruar në Mbretërinë Daneze.

Po ashtu, në këtë dokumentar çmohet lart roli i shtetit danez në përkrahjen e çështjes shqiptare etj etj. Ky film doku-

mentar ka për qëllim nxitjen edhe të shqiptarëve në vendet e tjera perëndimore për të bërë edhe dokumentar të tjerë që të mos harrohet vepra e lavdishme e mërgatës tonë për lidhjen me shpirt e me zemer me vendlindjen si dhe kontributi i tyre i çmueshëm në vendet ku jetojnë. Dokumentime të tilla i duhen opinionit dhe instancave përgjegjëse që merren me çështjen e emigracionit shqiptar. (ATSH)

“Butrinti Summer Festival” ringjall skenën antike

Festivali ndërkombëtar i teatrit në Butrint nisi mbrëmjen e 8 korrikut e do të vazhdojë deri më 14 korrik duke sjellë disa shfaqje në skenën antike me aktorët shqiptarë, por dhe të huaj. Këtë herë vijnë trupa nga Maqedonia, Ukraina, Greqia dhe Shqipëria. Për publikun do të shfaqen vepra të autorëve të njohur botërorë dhe nuk mungojnë veprat e antikiteti grek. Festivali nisi me komedinë “Nata e

dymbëdhjetë” e Shekspirit që e solli në skenë Teatri i Metropolit, vepër me regji nga amerikani Justin Anderson. Më datë 9 korrik në skenë do të vijë shfaqja performancë “Personazhet e dramës së antikitetit grek” nga regjisorët Dinos Koubatis, Pandelis Garios.

Vijon në festival dhe shfaqja “Njeriu dhe zjarri” bazuar mbi mitin e Prometheus me regji nga Dejan Projkovski nga

Maqedonia, ndërsa më 12 korrik do të vijojë shfaqja “Monger” nga artistët e TOB me koreografinë e izraelitit, Barak Marshall. Shfaqja e fundit në festival do të jetë “Kopshti i qershive” nga Anton Chekhov, që e sjell në skenë trupa e teatrit të Ukrainës me regji nga Yaroslav Fedoryshyn. Por festivali do të vijojë dhe me një natë tjetër mbrëmjen e datës 14 korrik. (ATSH)



Kënga fituese e "Eurovision"-it, e vjedhur?

Autorët e këngës fituese të Eurovisionit “Toy”, të interpretuar nga Netta, janë akuzuar për plagjiaturë. Kompania amerikane “Universal Music Studios” ka thënë se kënga e Nettës është kopjuar nga hiti i grupit amerikan “The White Stripes”, “Seven Nation Army”. Kritikët e muzikës kanë vënë re ngjashmëritë mes muzikës së dy këngëve, ndërsa avokatët e “Universal” kanë thënë se ka ngjashmëri në ritëm dhe në

harmonit. Publicisti i Nettës tha se këngëtarja që fitoi “Eurovision” këtë vit nuk dëshironte të komentonte këtë incident. Nëse në gjyq fiton kompania “Universal”, Izraeli rrezikon të humbasë çmimin e parë dhe të mos e zhvillojë festivalin “Eurovision” vitin e ardhshëm. Nëse vërtetohet diçka e tillë, triumfi pritet t’i kalojë shqiptarëve që përfaqësoi Qipron, Eleni Foureira, e cila u rendit e dyta.

Shtatë ditë me filmin dhe kuzhinën ballkanase në Pogradec

Ka ulur siparin edicioni i 8-të i Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë, në Pogradec. Një festival i cili zgjati plot 7 ditë me radhë ku u shfaqën mbi 70 filma të ndryshëm artistikë, dokumentarë dhe me metrazh të shkurtër.

Me çmim të parë u nderua filmi “Dita zë fill” i Gent Goçit, ndërsa çmimet e tjera shkuan për Bullgarinë, Slloveninë, Maqedoninë, Greqinë, etj. Për organizatorin e këtij festivali, Eno Milkani, edhe ky vit ishte një sukses, ndërsa ka ende disa sfida për t’u përmirësuar në festivalin e ardhshëm:

Ndërsa për Presidentin e Nderit të këtij festivali Viktor Zhusti ky edicion ka qenë një sukses i vërtetë, kombinimi e krijimtarisë me natyrën dhe turizmin kanë krijuar një atmosferë mjaft interesante dhe frymëzuese në Pogradec për këta krijues. Pjesë e festivalit edhe



këtë vit ishte Mish-Mash Production ku të rinj nga gjithë Ballkani prodhuan minireportazhe për çështjet e ndryshme sociale si dhuna ndaj fëmijëve apo edhe paqja. Çmimi i parë ka shkuar për “Let me Hug You”, një minireportazh i krijuar nga fëmijë nga Kosova e Serbia të cilët përcollën kështu mesazhin e paqes dhe dashurisë. Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë, prej vitesh përbën një ngjarje të rëndësishme për të

gjithë rajonin pasi në të promovohen filma nga shumë vende të Ballkanit si dhe kineastë të rinj.

Një risi për këtë vit në natën e fundit ishte premiera botërore e filmit të gjatë spanjoll “Zgjimi i Enver Simakut”. Në këtë film që frymëzohet nga Shqipëria e vitit 1997, interpretojnë ikona të kinematografisë shqiptare si Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Viktor Zhusti, Piro Milkani, Ema Andrea e Laert Vasili. (NOA)

STAND UP

Nga Gostivari starton karvani i Stand Up-it

Në Maqedoni çdo herë ka pasur mungesë të ngjarjeve kulturore të cilat kanë qenë udhëheqës të proceseve nëpër botë. Ti kur je më një ngjarje kulturore, me një shfaqje teatri, me një operë, me një koncert apo me një shfaqje teatri për fëmijë, menjëherë e kupton se futesh në botën e tjetrit, aktorit që është përballë teje. Në rast se ka shumë aktorë në skenë, ti futesh në mendjet e të gjithëve, në botën e të gjithëve, në imagjinatën e të gjithëve.

Maqedonia ka pasur shumë pak ngjarje që bota i njeh si Stand Up, lirisht mund të thuhet se publiku aspak nuk është ballafaquar me këtë shfaqje realiteti. Stand Up në vendet moderne është mënyra e qeshjes së realiteti dhe jetësimit të së tashmes nëpërmjet humorit. Të gjithë që dalin para publikut për Stand Up, janë njerëz të guximshëm dhe të aftë për të thënë gjërat si duhet, kur duhet dhe si duhet.

Artisti që merr guximin të del para jush për Stand Up, e di se ju atë ditë mund të keni pasur problem me faturat e ujit, keni fjetur pak apo edhe keni pasur problem me shefin. Por ju atë ditë do të qeshni, për të kuptuar se jeta juaj duhet të shihet me sy pozitiv. Të paktën, ju duhet të qeshni pasi një herë jetohe.

“Maqedonisë i vjen Stand Up i mirëfilltë, i bazuar në jetën, veprën, përditshmërinë dhe problemet tona të përbashkëta. Para jush, së shpejti do të jetë Hasim Memishi-Sopi, për të dhënë më të mirën që të paktën një ditë nga 365 ditë të jetës lumtur, me gaz dhe me harmoni. Me Stand Up ju e mësoni të vërtetën, pas së cilës mund të qeshni apo të mësoni. Duke filluar nga 15 korriku, nga sheshi i Gostivarit, karvani #StandUpSopi vjen në qytetin tuaj. Misioni jonë është të ju sjellim realitetin por në mënyrë të re”, thuhet në kumtesë.

FUTBOLLISTI BRAZILIAN ZBARKON NË ÇAIR

SERZHINJO ARRIN MARRËVESHJE DYVJEÇARE ME FC SHKUPI

“Ndjem i lumtur që sot kam veshur fanellën e klubit të madh siç është Shkupi, Sigurisht se deri sa kam luajtur në Maqedoni, për mua ka qenë kënaqësi kur luaja ndaj kësaj skuadre, pasi që gjithmonë kishte një atmosferë pozitive. Erdha këtu duke e ditur se projekti që më prezantuan kryesia është i madh, ndërsa shpresoj që sa më shpejtë të arrijë të jem ndihmë e klubit për të garuar për titullin kampion”, shprehet Serzhinjo



“League Evropa”, prezantoi dje edhe përforcimin e 5-të të merkatos verore. Pasi firmosi me Muarem Muarem, Amir Bilalin, Artan Veliun dhe portierin Igor Aleksovskin, FC Shkupi forcon radhët e veta me brazilianin Sergjio Antonio De Luiz Zhunior, ose më i njohur me shkurtesën Serzhinjo. Sulmuesi 23 vjeçar i krahut dje firmosi kontratën dy vjeçare dhe do të jep një shtytje dhe kualitet në sulmin e FC Shkupit. “Ndjem i lumtur që sot kam veshur fanellën e klubit të madh siç është Shkupi, Sigurisht se deri sa kam luajtur në

Maqedoni, për mua ka qenë kënaqësi kur luaja ndaj kësaj skuadre, pasi që gjithmonë kishte një atmosferë pozitive. Erdha këtu duke e ditur se projekti që më prezantuan kryesia është i madh, ndërsa shpresoj që sa më shpejtë të arrijë të jem ndihmë e klubit për të garuar për titullin kampion”, deklaroi Serzhinjo. Ndryshe, kryesia e FC Shkupi falënderon kryesinë e KF Skënderbeu dhe në veçanti drejtorin sportiv Haris Fakiç, të cilët në mënyrë shoqërore mundësuan për blerjen e kartonit të futbollistit brazilian. Cekim,

më parë Serzhinjo ishte pjesë e skuadrave të Hajvalisë, Skënderbeut, Laçit dhe së fundit Rabotniçkit. Në kampionatin e Shqipërisë ka regjistruar 36 paraqitje për Skënderbeun dhe Laçin, duke shënuar edhe 4 gola. Ndërkohë për një sezon te Rabotniçki shënoi 5 gola në 23 paraqitje. Serzhinjo është lindur në Bello Horizonte të Brazilit dhe ishte pjesë e skuadrës Vitoria, e cila është pjesë e kampionatit elitare të Brazilit, para se të nis aventurën evropiane te skuadra e Hajvalisë, në vitin 2015, në moshën 20 vjeçare.



“Ballisti” lirohet nga burgu kroat

Ismail Morina “Ballisti” është liruar nga paraburgimi të martën. Lajmin e ka konfirmuar vetë ai përmes një statusi në rrjetin social “Facebook”. Morina, i cili e drejtoi dronin mbi stadiumin e Beogradit mbrëmjen e 14 tetorit të vitit 2014, gjatë ndeshjes kualifikuese për Evropianin 2016 mes Serbisë dhe Shqipërisë, ka njoftuar se është liruar nga paraburgimi në Itali, falë konsullit të Shqipërisë në Itali, Adrian Haskaj. Ai e ka falënderuar shtetin shqiptar për përpjekjet për ta liruar atë, si dhe Kroacinë dhe Italinë që kanë qenë të paanshme në këtë proces. Cekim, Beogradi vazhdimisht e ka kërkuar ekstradimin e tij duke e akuzuar për nxitje urrejtje mes popujve. Edhe pse fillimisht e kishin pranuar kërkesën e Serbisë, autoritetet kroate, aty ku Morina ishte mbajtur në paraburgim, pas një seance gjyqësore kishin vendosur përfundimisht ta hedhin poshtë kërkesën e palës serbe, duke mos e ekstraduar në kryeqytetin serb. Në fillim të këtij viti, ai u transferua në një burg në Itali, në vendin banor i të cilit është prej kohësh. “Me konsullin e përgjithshmen të Republikës së Shqipërisë të akredituar në Bari të Italisë Zotërinë/Dashamirin Adrian Haskaj. Përgëzime të veçanta strukturave të shtetit shqiptar që janë përfshirë në përpjekjet për lirim tim, respekt për Kroacinë dhe Italinë në paanshmërinë e treguar prej tyre dhe mirënjohje gjithë atyre që zbritën rrugëve të kryeqytetit shqiptar në mbrojtjen time. I LIRË. Rroftë shpirti i shqiptarit!”, ka shkruar Ballisti në “Facebook”.

Shkup, 10 korrik - Skuadra e FC Shkupit në prag të shkuarjes për në Skoci, ku do të përballet me Renxhersin në Glasgou, në kuadër të raundit të parë eliminator të

“ROMANTIKËT” NUK DORËZOHEN PARA HONVEDIT

Stjepanoviç: Kemi gjasa reale të kalojmë në raundin e dytë



Shkup, 10 korrik - Skuadra e Rabotniçkit sonte (e mërkurë) në qendrën stërvitore “Petar Millosheviski” pranë FFM-së, do të përballet me hungarezët e Honvedit. Nga radhët e “romantikëve” edhe një herë rolin e favorit ia lënë mysafirëve të tyre, megjithatë mesfushori dhe kapiteni i tyre Ostoja Stjepanoviç, beson se skuadra e tyre ka gjasa reale të kalojmë në raundin e dytë

eliminator të Ligës së Evropës. “Ajo që na përket neve është që ne të japim maksimumin në këtë ndeshje dhe mos të kursejmë asgjë dhe në fund do të shohim se kjo për çfarë do të jetë e mjaftueshme. Unë shpresoj se kemi cilësi dhe nëse japim maksimumin, do të mund të bëjmë rezultat të mirë”, deklaroi Stjepanoviç. Përballja mes Rabotniçkit dhe Honvedit fillon në ora 17:30.

RENOVA ZHVENDOSËT NË OHËR

Më 17 korrik kundër Skënderbeut

Shkup, 10 korrik - Skuadra e Renovës nga dje po qëndron në Ohër, ku në 15-të ditët e ardhshme do të realizon fazën e dytë përgatitore. Nga klubi bardhekalter, trajneri i së cilës është Jeton Beqiri, besojnë në përgatitje të mira, ndërsa në faqen e tyre zyrtare në “Facebook” njoftuan edhe për

kundërshtarit e parë që do të zhvillojnë në kuadër të ndeshjeve kontrolluese. “Pas përfundimit të fazës së parë përgatitore në Tetovë, skuadra është zhvendosur në Ohër, ku do të qëndrojë për 15-të ditë. Ndërkohë, më 17 korrik, Renova do të vizitojë qytetin e Korçës ku edhe do të zhvillojë një

ndeshje miqësore me skuadrën e Skënderbeut”, thuhet në postimin e KF Renova në “Facebook”. Cekim, pos trajnerit të ri Jeton Beqiri, Renova në radhët e saja solli edhe përforcimet si Miran Maksuti, Fisionik Zuka, Ylber Beqiri, Aleksandar Risteviski dhe Nikolla Pantoviq. (B.K.)





REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënpusëve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 100/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „IPK Shtëpinë e Pleqve Kiro Krsteski Platnik Prilep“ për vendet e punës në vijim:

1. SOZ0102V01001 Këshilltar - Jurist, Njësia për çështje juridike, të përgjithshme dhe menaxhim me resurset njerëzore 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkenca juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjike
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës:

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Rroga neto: 23.655,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

KOMUNA E KËRÇOVËS

Në bazë të Programit për financimin e aktiviteteve nga lëmi i kulturës, nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje e shoqatave të qytetarëve për vitin 2018 ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Kërçovës" nr. 04/2018), Komuna e Kërçovës shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018, të caktuara për mbështetjen e shoqatave kulturore

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018, në pajtim me Programin për financimin e aktiviteteve nga lëmi i kulturës, nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje e shoqatave kulturore për vitin 2018 nr. 08-1012/9 nga dt. 23.4.2018, mjetet e caktuara për financimin e aktiviteteve kulturore, do të bëhet në bazë të kriterëve dhe përparësive sipas Rregullorja nr. 09-741/1 nga dt. 23.3.2016 të dhëna në këtë thirrje.

1. Lloji i projekteve që do të mbështeten

Mjetet nga Buxheti i Komunës së Kërçovës, do të shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave kulturore, për projekte nga këto kategoritë:
Mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve për organizimin e festivaleve, shënimin e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme, financimi i manifestimeve kulturore, inkurajimin e krijimtarisë bashkëkohore dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

2. Mjetet e parapara

Për financimin e aktiviteteve programore të ofruara, në pajtim me thirrjen, do të shfrytëzohen mjete nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2018 edhe atë:

1. Financimi i interesit lokal në kulturën e Komunës së Kërçovës, si dhe realizimi i këtij programi do të zhvillohet si vijon:

1. Organizimin e festivaleve në territorin e Komunës së Kërçovës600 000 den.
2. Shënimin e ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme..... 600 000 den.
3. Financimi i manifestimeve kulturore..... 700 000 den.
4. Inkurajimi i krijimtarisë bashkëkohore..... 250 000 den.
5. Projekte të shoqatave joqeveritare.....600 000 den.
6. Promovimi i trashëgimisë kulturore..... 300 000 den.
7. Financimi i institucioneve publike, për të shënuar ngjarjet jubilarë, datat e rëndësishme dhe patronatet dhe të tjera.....200 000 den.
8. Financimi i artistëve individualë, arteve zbatuese, dhe të ngjashme.....300 000 den.
9. Ndihmë e manifestimeve të të rinjve me përmbajtje kulturore-artistike dhe argëtuese- edukative.....200 000 den.

3. Dorëzimi i raportit

Shoqatave kulturore do t'u jepen mjete në pajtim me Programin për financimin e aktiviteteve nga lëmi i kulturës, nga interesi i Komunës së Kërçovës dhe përkrahje e shoqatave të qytetarëve për vitin 2018 dhe pas përfundimit të aktiviteteve të veta programore, shoqatat do të dorëzojnë Raport për shfrytëzimin e mjeteve, deri te Sektori për Financa në Komunën e Kërçovës.

4. Kriteret themelore organizative

Kriteret themelore organizative të cilat duhet t'i përmbushin shoqatat kulturore që do të marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Kapaciteti i organizatës
- Relevanca e aksionit të ndërmarrë
- Efektet në mjedis
- Qëndrueshmëria e projektit
- Pjesëmarrje vetanake në financim (me kohë, pajisje, burime njerëzore)
- Konzistenca e projektit (qëllimet, aktivitetet, rezultatet, buxheti)
- Ndarja e saktë e roleve të partnerëve

5. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqatat duhet ta dorëzojnë me Paraqitjen për mbështetje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve:

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në shpallje, duhet të paraqesin:

1. Fletëparaqitje për mbështetje financiare;
2. Buxhetaplikimin;
3. Aktvendim për regjistrimin e shoqatave;
4. Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Komunës së Kërçovës në vitin e kaluar fiskal dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse shoqata ka qenë shfrytëzuese e mjeteve të ndara nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2017);

Shoqatat qytetare mund të dorëzojnë vetëm një paraqitje për përkrahje financiare për projekt ose manifestim.

Vërejtje: Paraqitjet e dokumenteve të pa plotësuara dhe pas përfundimit të afatit të parapara nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk do të kthehen.

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të paraqitjes

Afati për dorëzimin e paraqitjeve, është 20 (njëzetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore dhe në faqen elektronike të Komunës së Kërçovës.

Paraqitja me dokumentacionin gjithëpërfshirës, të dorëzohet përmes postës, në adresën: Komuna e Kërçovës rr. "Boris Kidriç" nr.1 6250 Kërçovë, ose në Arkivin e Komunës nga ora 08:00 deri më 16:00, me përshkrimin - Për mbështetjen e shoqatave kulturore për vitin 2018.

Shoqatat kulturore pjesëmarrëse në thirrjen publike, do të jenë të informuara për rezultatet pas publikimit të vendimit për shpërndarjen e mjeteve në "Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës". Emrat e shoqatave të cilat kanë fituar mjete për projektet, do të publikohen në faqen elektronike të Komunës së Kërçovës.

Paraqitjet për mbështetje financiare të shoqatave dhe formularit për Propozim-projektin, do të mund të merren në Arkivin e Komunës së Kërçovës dhe web.kercova.gov.mk

Komuna e Kërçovës



SHOQËRIA AKSIONARE PËR NDËRTIM DHE EKONOMIZIM ME HAPËSIRË BANESORE DHE ME HAPËSIRË AFARISTE ME RËNDËSI PËR REPUBLIKËN – SHKUP



rr. Orce Nikolov nr. 138, Shkup, fahu postal 474 tel: 3111-387

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18), Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup publikon:

Shpallje publike Për nevojën e punësimit të punëtorëve për kohë të pacaktuar

Shoqëria aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup ka nevojë për punësim të 6 punëtorëve për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

1. Për vendin e punës "Referent përgjegjës për realizim" në Sektorin për çështje juridike dhe të përgjithshme, Departamentin për procedura gjyqësore dhe të tjera, Seksioni për realizim në Drejtorinë e shoqërisë aksionare – 1 realizues me PSP të mbaruar, jurist i diplomuar dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 36.400,00 denarë.

2. Për vendin e punës "Referent i pavarur për çështje ekonomike" në Sektorin për ndërtim dhe rregullim të tokës ndërtimore, Departamentin për përgatitje në Drejtorinë e shoqërisë aksionare – 1 realizues me PSP të mbaruar, ekonomist i diplomuar dhe 1 (një) vit përvojë pune pas përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 34.700,00 denarë.

3. Për vendin e punës "Referent i pavarur për çështje teknike" në Sektorin për mjete afariste në bazë të transformimit në Drejtorinë e shoqërisë aksionare - 1 realizues me PSP të mbaruar dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 34.700,00 denarë

4. Për vendin e punës "Referent i pavarur" në Sektorin për ekonomizim me hapësirë afariste, Departamentin për evidencë amë dhe financiare të hapësirës afariste, Seksioni për kontroll në terren, në Filialin Shkup të shoqërisë aksionare - 1 realizues me PSP të mbaruar dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 31.180,00 denarë

5. Për vendin e punës "Referent për koordinim të kontrollit në terren" në Sektorin për ekonomizim me hapësirë afariste, Departamentin për evidencë amë dhe financiare të hapësirës afariste, Seksioni për kontroll në terren, në Filialin Shkup të shoqërisë aksionare - 1 realizues me PMP KU dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 31.180,00 denarë

6. Për vendin e punës "Koordinator kryesor" në Filialin Veles të shoqërisë aksionare - 1 realizues me PSP të mbaruar dhe 1 (një) vit përvojë pune pas marrjes së përgatitjes së kërkuar profesionale;

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte (40 orë), 8 orë pune në ditë (fillimi mes orës 7.30 dhe 8.30, mbarimi rreth orës 15.30 dhe 16.30), neto pagesa bazë 30.290,00 denarë

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në pajtim me ligjin si dhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës së Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup edhe atë:

- të kenë arsim të mbaruar përkatës të theksuar në shpallje për vendin konkret të punës dhe 1 vjet përvojë pune që kandidati e ka kaluar në punë pas arrijtes me përgatitjen e kërkuar profesionale.

Kandidatët krahas fletëparaqitjes (fletëparaqitje të shkruar me dorë me kontakt telefon dhe adresë) për vendin e punës për të cilin paraqiten duhet të dorëzojnë dokumente/dëshmi për plotësimin e kushteve të theksuara edhe atë:

- Diplomë, certifikatë ose dëftesë për arsimin e mbaruar me përgatitjen e kërkuar profesionale (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Dëshmi për përvojën e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë e shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);

Afati për paraqitjen e kandidatëve është 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin dorëzohet në adresën e Shoqërisë aksionare për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup – Drejtoria, rr. "Orce Nikolov" nr. 138, Shkup, përmes postës ose në arkivin e shoqërisë aksionare çdo ditë pune prej ora 8.30-16.30.

SHA për ndërtim dhe ekonomizim me hapësirë banesore dhe hapësirë afariste me rëndësi për Republikën – Shkup do të bëjë zgjedhjen e kandidatëve të paraqitur në afatin e parapara ligjor (45, 90 ose 120 ditë), varësisht nga numri i fletëparaqitjeve të arritura. Personi për kontakt: Z. Nedanovski, tel. 02/ 2 633-833

Në bazë të nenit. 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e R.M nr.. 167/15), neni.103 nga statusi i SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë, pas marrjes së lajmërimit për sigurimin e mjeteve financiare nr. 12-1347/1 nga 01.02.2018 dhe nr. 12-108/4 nga 20.03.2018 e Ministrisë për Arsimit dhe Shkencë dhe pas marrjes së pëlqimit nga plani vjetor për punësim për vitin 2018 nr.12-5856/2 nga 21.05.2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe pas marrjes së mendimit pozitiv të planit vjetor për punësim për v.2018 nr..12/6-3713/2 nga 19.06.2018 nga Ministria e shoqërisë së informacionit dhe administratës, drejtori i SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë, publikon :

Shpallje publike

Për krijimin e marrëdhënieve pune për kohë të pacaktuar pune për kuadrin jomësimore- personel ndihmës teknik në bazë të financimit të vjetër për këto vende:

- 1.) -1 (një) person për vendin e punës roje nate
- 2.)-1 (një) person për vende pune mirëmbajtje higijene

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e parapara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës dhe në Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores edhe atë:

-për vendin e punës roje nate

- të ketë të mbaruar shkollimin e mesëm
- të posedojë certifikatë për roje nate
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-Për vendimin e punë mirëmbajtje higijene

- të ketë së paku shkollimin fillor
- të jetë nënshkretas i Republikës së Maqedonisë

Vendet e punës së lartpërmendura janë për kohë të pacaktuar të punës, për vendin e punës roje nate koha e punës është nga ora 22:00-06:00 dhe për vendin e punës mirëmbajtës higijene koha e punës është në ndërrime edhe atë nga ora 06:00 deri 14:00, dhe nga ora 14:00 deri 22:00,ditët e punës nga e hëna deri të premten, dhe kujdestari një të shtunë në muaj me orar pune dyndërrimeshe dhe për të dy venet e punës paga është 12.000,00 denarë.

Kandidatët e interesuar mund të paraqiten me dokumentet e nevojshme për plotësimin e kushteve (original apo fotokopje të notariuara tek notari) personalisht në arkiv apo nëpërmjet postës në adresën :SHMTK "Nace Bugjoni" rr. Bajram Shabani pn 1300, me shenjim të shpalljes publike .

Shpallja publike do të zgjasë 5 ditë pune nga publikimi në gazetë.

Paraqitja jo në kohë dhe pa dokumentet e kompletuara nuk do të shqyrtohen,.

Informacione më të detajuara në tel.: 031-432-180 ,faks 031-437-321. Personi për kontakt Magdalena Krstevska.

SHËNIM: vendet e parashikuara për punë në përputhje me planin vjetor të institucionit për 2018 janë: Shqiptar (shqiptare) 2.

Nga

SHMTK" Nace Bugjoni" Kumanovë

Koha
www.koha.mk • WEB FAQJA MË E VIZITUAR

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Largimi i mundshëm i Cristiano Ronaldos drejt Juventusit pritet të shkundë botën e futbollit, ose të ketë të ashtuquajturin "efekt domino". Sulmuesi portugez mund t'i dërgojë pesë "Topat e Artë" të tij në Seria A, ku duket se ka gjetur gjithçka që kërkon

Lëvizja do të ishte aq tronditëse në futboll, sa mund të modifikojë sulmin e disa ekipeve më të mëdha në Evropë. Dhe kjo tregon se KR7 nuk do të ishte një transferim normal. Menaxhmenti i Juventusit do të jetë vendimtar për të krijuar një skuadër rreth "Lusos", e aftë për të fituar Ligën e Kampionëve, aq shumë e dëshiruar nga presidenti Andrea Anjeli dhe tifozët bardhezinj. Disa informacione mediatike në Itali flasin për një largim të mundshëm të Higuain, për të gjenuar para dhe reduktuar shpenzimet e mëdha, që do të angazhohen në "operacionin Ronaldo".

LAMTUMIRA E MUNDSHME E RONALDOS DHE "EFEKTI DOMINO" NË EVROPË



E ardhmja e "Pipita" duket në Londër. Dhe në mënyrë specifike, te Çells. Sipas "Mediaset Italia", marrëveshja mes klubeve do të ishte e përgjithshme dhe argjentina si do të transferohej në ekipin anglez për 60 milionë euro. Shkuarja e supozuar e Higuain te blutë e Londrës do të shkaktonte një tejka-

lim të sulmit aty, çka do të detyronte largimin e disa prej lojtarëve të këtij reparti. Mes të cilëve, i përzgjedhuri do të ishte edhe Morata. Lëndimet ishin një kalvar për ish-sulmuesin e Real Madridit në vitin e tij të parë në "Stamford Bridge", deri në pikën e humbjes së vendit të titullarit në favor të Oliver

Zhirud. Fati i sulmuesit spanjoll mund të jetë Bajern Munihi. Sipas "Bild", skuadra gjermane ka fokusuar dy emra për të zëvendësuar të larguarin e mundshëm, Robert Lewandovski: Kavanin dhe Moratën. Edhe pse skuadra gjermane nuk e bën të lehtë privimin nga sulmuesi polak, duket se koha e këtij të

fundit në Bundesliga ka mbaruar dhe, madje, përfaqësuesi i tij e bëri të qartë se më e mira do të ishte ndarja e rrugëve. Dhe ku mund të përfundojë Levandovski? Shumë është thënë për flirtimin e tij me Real Madridin. Niko Kovaç, trajneri i ri i Bajern Munihi, thotë se "edhe sezonin e ri, Levandovski do të vazhdojë me bavarezët", pavarësisht nga lëvizja që po gjeneron futbollin evropian. Performanca e tij e keqe në Kupën e Botës nuk ndihmon asnjë klub, që përpiqet të bëjë një përpjekje ekonomike për një lojtar 30-vjeçar në muajin gusht. Me Levandovski në ajër, mbetet për të zbuluar lëvizjen më të rëndësishme. Kush do të shkojë në Madrid, nëse Cristiano Ronaldo largohet? Nuk ka dyshim se përgjigja e kampionit evropian duhet të jetë galaktike. Dhe atje, sfera është shumë e kufizuar. Neymar, Mbappe, Kin dhe shumë pak të tjerë mund të përpiqen të lehtësojnë traumën e madhe të largimit të flamurit të Real Madridit në dekadën e fundit.

Torres zyrtarizon kalimin te Sagan Tosu



Sulmuesi spanjoll Fernando Torres ka konfirmuar se do t'i bashkohet Sagan Tosu. Ish-futbollisti i Liverpoolit, Çellsit dhe Atletiko Madridit, u largua nga Atletiko në fund të sezonit 2017/18, pas kthimit emocional në klubin e fëmijërisë. Torres ka qenë në bisedime me Sagan Tosu që prej fillimit të këtij muaji, edhe pse thuhet se bisedimet kishin

dështuar. Megjithatë, ai gjeti gjuhë të përbashkët me klubin japonez për ta vulosur transferimin në ligën japoneze. Sagan Tosu momentalisht renditet e 17-ta në J-League, në vendin e parafundit, pasi i ka fituar vetëm tri nga 15 ndeshje deri tani këtë sezon. Torres i shënoi 10 gola në sezonin e tij të fundit në Atletiko.

Publicitet



Barcelona në sulm për Hazardin!

Eden Hazard është ylli në faqet e para të mediave të Barcelonës këtë të martë. Gjithmonë sipas gazetës "Sport", ndërkombëtarin belg, që po vijon të luajë në Botërorin e Rusisë, është objektiv madhor i Erik Abidal dhe sekretariatit teknik të Barcelonës, i cili tashmë po punon me diskrecion të plotë për të siguruar nënshkrimin e një prej yjeve të Kupës së Botës, i cili, gjithashtu, është lidhur me Real Madridin. Hazard nuk do të luajë Çampionat sezonin e ardhshëm, nëse mbetet pjesë e Çellsit, dhe ky është një faktor kyç në dëshirën e tij për t'i lënë blutë e Londrës. Barça dëshiron ta përdorë këtë gjë

për të siguruar nënshkrimin e tij dhe "plasur bombën" verore, duke bashkuar në të njëjtin ekip, në "Camp Nou", Messin, Suarezin, Kutiñon dhe Hazard. Nga ana tjetër, "Mundo Deportivo" zgjedh dy emra të tjerë të duhur për faqen e parë të saj. I pari prej tyre është Luis Enrique, emërimi i të cilit si trajner i kombëtares iberike ka nënkuptuar një ndikim të përgjithshëm në futbollin spanjoll. Përveç kësaj, Arthur është protagonist kryesor i faqes së parë. Brazili mbylli nënshkrimin e tij mbrëmë, deri në vitin 2024, pasi Barça pagoi 31 milionë euro, plus 9 të tjera në formë variablash.

Publicitet

URGJENTISHT
Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr +1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe Pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-7085/2 të datës 28.06.2018, Drejtori i IPKÇF "Aco Karamanov" – Radovish, publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM PËR KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS

1. Një (1) person në vendin e punës edukator për fëmijë prej moshës 2-6 vjet, për kohë të pacaktuar të punës Shkalla e arsimit: profesor i diplomuar për edukatë parashkollore, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukatë parashkollore - me 240 kredi sipas EKTS apo arsim të lartë të mbaruar shkalla VII/1 apo me arsim të lartë përkatës të mbaruar për edukatorë.

- me ose pa përvojë pune,
- neto pagesa mujore me PLP: 18.510,00 den, me PSP: 19.575,00 den.
- orari ditor i punës: ora 7,00-15,00, prej të cilave 6 orë punë me fëmijë,
Orari javor i punës: 40 orë, (8 orë në ditë prej ditës së hënë deri ditën premte)

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrorin edhe dokumentet në vijim:

- Dëshmi për arsim të mbaruar,
- Certifikatë të shtetësisë,
- Dokument se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Dokument, se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligj është përcaktuar sjellje diskriminuese.

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditë pas kalimit të shpalljes.
Lutja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrorët deri në IPKÇF "Aco Karamanov" – Radovish, rr. "Aco Karamanov" nr. 54, Radovish.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrorin në afatin e caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk i përmbajnë dokumentet e kërkuara, do të konsiderohen si të dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara dhe nuk do të merren parasysh.

Drejtor,
L. Trençeva

U REFUZUA NGA SHUMË KLUBE KROATE, POR SOT E DUAN TË GJITHË!



Luka Modrić është dashur të kapërcejë shumë vështirësi serioze përpara se të bëhej një futbollistë profesionist. Por, kjo nuk e ndaloi djalosin që të shkëlmonte një top futbollit të vogël dhe të luante në parkingun e hoteleve, duke ëndërruar që një ditë fitonte ekzistencën e tij që ishte shkatërruar nga lufta

Kur kapiteni i Kroacisë ishte vetëm 6 vjeç, jeta e tij u trondit kur gjyshit i tij i dashur ra në duart e banditëve militantë serb, ndërsa ai u detyrua të jetonte si refugjat në atdheun e shkatërruar nga lufta. Por, pavarësisht vështirësive të tilla, kjo nuk e ndaloi djalosin ambicioz që të bëhej një nga lojtarët më të mirë të planetit dhe tani si 32 vjeçar, një super yll global.

Më 8 dhjetor 1991, gjatë Luftërave Ballkanike, milicia e dhunshme serbe e sulmoi Modriçin, një fshat i vogël pranë maleve të Velebit në Dalmacinë Veriore dhe shkaktoi terror për familjet kroate që nuk kishin ikur nga vendlindja. Luka Modrić Snr (gjyshi), i cili po i ruante bagëtitë e tij në një rrugë të braktisur, u kap nga një grup serbësh ku u ekzekutua brutalisht së bashku me pesë vendas të tjerë. Ideja ishte të dërgohej një mesazh të banorët e tjerë të Modriçit që ata duhet të largoheshin nga qyteti i tyre. Vdekja e goditi fort Lukan. Ai ishte rritur nga gjyshi i tij Luka Modrić Snr, pasi që prindërit e tij Stipe dhe Radojka punonin për orë të gjata në

një fabrikë veshjesh për të mbështetur familjen financiarisht. Pas incidentit, prindërit e tij u detyruan të largoheshin nga Modriçi dhe kërkuan strehim në hotel "Iz" në qytetin e Zadarit. Qyteti Zadar u kthye në shtëpi të dytë të Modriç. Pa energji elektrike apo ujë të pijshëm, zhurmat e granatave dhe plumbave u bënë një dukuri e përditshme për Lukën dhe motrën e tij Jasminën, për të mos përmendur shmangien e minave tokësore që mund të dërgonin tek vdekja në çdo moment. Por, kjo nuk e ndaloi djalosin që të shkëlmonte një top fut-



Kur filloi lufta u bëmë refugjatë dhe kjo ishte një kohë shumë e vështirë. Isha gjashtë vjeç. Ishin kohë të vështira. Ne jetuam në një hotel për shumë vite, ndërsa ne luftonim edhe financiarisht, por gjithmonë e doja futbollin. Mbjaj mend që mbrojtëset e mia të para i kam pasur të Ronaldos brazilianit dhe i kam dashur shumë ato. Lufta më bëri më të fortë, ishte një kohë shumë e vështirë për mua dhe për familjen time. Unë nuk e përmend gjithmonë, por nuk do ta harroj atë

bolli të vogël dhe të luante në parkingun e hoteleve, duke ëndërruar që një ditë fitonte ekzistencën e tij që ishte shkatërruar nga lufta. Është një rrëfim i shkëlqyer për të pasurit, që është testament i përkushtimit, pasi që katër herë fituesi i Ligës së Kampionëve, e ka arritur këtë pas një tragjedie të tmerrshme.

Modrić rrallë flet për vështirësitë e tij, por kur ai nënshkroi për Totenhemin në vitin 2008, foli për këtë periudhë të fëmijërisë së tij. "Kur filloi lufta u bëmë refugjatë dhe kjo ishte një kohë shumë e vështirë. Isha gjashtë vjeç. Ishin kohë të vështira. Ne jetuam në një hotel për shumë vite, ndërsa ne luftonim edhe financiarisht, por gjithmonë e doja futbollin. Mbjaj mend që mbrojtëset e mia të para i kam pasur të Ronaldos brazilianit dhe i kam dashur shumë ato. Lufta më bëri më të fortë, ishte një kohë shumë e vështirë për mua dhe për familjen time. Unë nuk e përmend gjithmonë, por nuk do ta harroj atë", kishte treguar Modrić pasi nënshkroi për Totenhemin. Kjo është një rezistencë mendore që i ka shërbyer edhe Modriçit gjatë karrierës së tij. Megjithatë, kur Modrić ishte 10 vjeç, ai nuk u pëlqye madje u refuzua nga disa trajner. Hajduku i Splitit nuk e pranoi, por ishte Tomislav Basić, një trajner që e njihte Modriçin nga Zadar, e mori në prova te Dinamo Zagreb. Nga aty talenti i tij lulëzoi, ku kaloi te Totenhem dhe pastaj te Real Madrid ku edhe sot është një shtyllë e këtij klubi dhe një nga futbollistët më të vlefshëm në botë.

Jeta e tij personale nuk mund të ishte shumë më e mirë. Ai u martua me Vanja Bosnić, e cili është agjente e tij. Ai i dha fund beqarisë në vitin 2010 në kryeqytetin kroat, Zagreb. Çifti u takuan për herë të parë në agjencinë sportive Mamić, ku ajo punonte. Ish-bashkëlojtari i Totenhemit dhe tani te Kroacia, Vedran Čorluka, ishte dëshmitar kryesor në martesën e tyre. Fëmija i parë i çiftit është djali Ivano dhe lindi vetëm tri javë pas martesës së tyre. Pastaj ka edhe dy vajza, Ema dhe Sofja.



DASHI 21. mars - 20. prill
Mundohuni të jeni krijues dhe të frytshëm, në mënyrë që të gjeni gjallërinë që ju duhet për të çuar përpara projekte unike dhe interesante. Ky është moment shumë i mirë nga pikëpamja profesionale. Këshillohet që në dashuri të jeni më të durueshëm.

DEMI 21. prill - 21. maj
Ju pret një ditë e cila do ju lejojë që ti jetoni lidhjet profesionale me më shumë qetësi. Lini mënjatë të gjitha keqkuptimet dhe përqendrohuni vetëm në çështjet e rëndësishme. Orët e pasdites do ju shohin dinamik dhe euforik.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Ky është një moment i rëndësishëm për të riparë të gjitha kontaktet dhe të nisni bashkëpunime të reja të rëndësishme për karrierën tuaj. Do të jeni të gatshëm që të përballeni me disa sqarime në dashuri. Me partnerin/en do të arrihi të gjeni harmoninë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Parashikohet një ditë gjatë së cilës do të jeni të "mbytur" nga puna dhe nga afate që duhen respektuar. Mos u përfshini nga ankthi, por përqendrohuni vetëm në realizimin e projekteve tuaja. Do të keni një intuitë shumë të mirë, të cilën mund ta shfrytëzoni në avantazhin tuaj.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Do të keni mundësi që të zbuloni disa strategji interesante për të vënë në jetë në vendin e punës. Sigurisht, duhet të jeni të gatshëm që të pranoni disa kompromise të vogla, por që do të jenë tejet të dobishme për realizimin e një projekti. Në dashuri këshillohet të jeni kurajoz.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Mundohuni që të mos dorëzoheni përpara provokimeve të tjerëve, sidomos nëse në këtë periudhë jeni shumë emotiv. Duhet të jeni më të matur në menaxhimin e kursimeve tuaja ekonomike.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Kjo e martë do të jetë shumë e rëndësishme për ndjenjat, ku do të keni mundësi që të përballeni me një person i cili ju intereson dhe do të zbuloni më shumë lidhur me historinë dhe eksperiencat e tij. Mos u druani që të tregoheni të hapur dhe të tregoni gjithë sa dini, në momentet që duhet.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Duhet të mundoheni të jeni më të fortë, pasi kjo është një ditë e cila do ju gjejë nën presion. Duhet të jeni gati që të ballafaqoheni me disa kolegë tuaj kokëfortë. Jepini vlerë vetes tuaj dhe mos lejoni askënd që të dëmtojë nismat tuaja. Në dashuri do të ketë shkëndija.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Do të keni më në fund mundësi që të merrni një rol me më shumë përgjegjësi dhe kjo do ju lejojë që të tregoni të gjitha aftësitë tuaja. Do të jeni autoritar, pa u munduar që të vini në pozitë kolegët tuaj. Në dashuri do të merrni përgjigje pozitive.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Keni nevojë për disa ditë pushimi për t'u qetësuar dhe për të larguar të gjithë mendimet negative që ju inatosin dhe tensionojnë. Ky është një moment i mirë për të rigjetur ekuilibruan dhe stabilitetin e brendshëm. Kaloni më shumë kohë cilësore me familjen.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Kjo është një periudhë mjaft e rëndësishme për karrierën tuaj. Duhet të jeni të vendosur dhe të mos ndaleni përballë kritikave të tjerëve. Përgjigje të rëndësishme dhe konfirmime, janë fare pranë.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Kjo e martë do ju gjejë të përhumbur në reflektime, sidomos nëse në vendin e punës do të bëni ndryshime drastike, të cilat do të çojnë përpara karrierën tuaj. Në dashuri dhe në familje, mos jini shumë egoistë.

Mensur Mamuti	AKADEMIKU DHE AUTORI KOSOVAR NË FOTO	VEPRA E AUTORIT NË FOTO "NË MBROJTJE TË PAVARESISË SE..."	PUNËT TINEZAKE	SH.PRESIDENTI ARGJENTINAS, HUAN	SHKRONJË GREKE	 <p>NE KETE DATE</p> <p>11 KORRIK 1942 17 GUSHT 2015</p>
SKUADRA, KLUBE						
LLOJ VJERSHE LIRIKE, TINGËLLIMË						
LLOJ OPELI						
POPULL NË UGANDË					RITMISTJA RUSE, VERA	
LLOJ MUZIKE POPULLORE AMERIKANE						
KRABËZ PËR QENDISJE BUBA, FERHAN				REOMIRI AUTOR SHQIPTAR (1906-1972)		
H						
VOLTI		ZË QYTET NË TURQI				
4 ROMAK			PËREMËR VETOR USHTARAKU SHQIP. I LDB, GJELOSHI		OA	
AUTOMJET ANGLEZ					BOTIMI I PËRVITSHËM	
MAJA E MIELLIT				AMERICAN JOURNAL OF NURSING LALË (BISED.)	AKTORI AMERIKAN, KUIN	
KARBONI		LUMË NË NIGERI NJË PRIND		ETILEN I NGOPUR PËRFUNDIM I LUTJES	RUMANIA	
MAKINË PËR NJËRRJË ZOGJSH					AMPERI SHËSHI I DYLUFTIMIT	
KOHA	Ë AF		PORTET UR			
AKTORJA FRËNGJE, EME				MODELJA RUSE, ISH PARTNERJA E RONALDOS, SHAJK OZONI		
MBRETI NË EGJIPTIN E LASHTË					FLORI	

ZGJIDHJET: EKIPE, SONEJ, ASTRA, TORO, SVING, TËG, R, HASANI, V, TON, IV, NE, LAND ROVER, ENDA, AJN, A, C, OBA, ETAN, INKUBATORE, E, LIMANET, ANUK, IRINA, FARAONI, AR.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

9				4							2				6		
8		1		6				7		1		4		5		7	
6	7			2				4	8		9		1		3		2
			6	1				2		6			7			8	
			5	3							1	9		6	7		
3						4	8			7			3			6	
									6		7		5		4		1
				5			3			2		7		1		3	
7					2	6		8			5				8		

Shumë i lehtë: 952784163, 841936527, 673521849, 486175392, 295348716, 317269485, 564893271, 128657934, 739412658. Mesatar: 742389615, 316425978, 859617342, 963572184, 281946753, 574138269, 697853421, 428791536, 135264897.

Kravatat pengojnë qarkullimin e gjakut në tru



Kravatat janë një dukje standard për meshkujt që punojnë në zyrë, duke filluar nga qendrat e thirrjeve e deri tek bankat. Megjithatë një studim i ri ka paralajmëruar se ky aksesor mund të pengojë performancën tuaj duke ushtruar presion mbi venat që janë qenësore për qarkullimin e gjakut në tru. Studimi i përmasave të vogla me 30 meshkuj të rinj nga Gjermania ka gjetur statistikisht një ulje të funksionimit të trurit tek meshkujt që kishin të vendosura kravata gjatë skanimit MRI, me një qarkullim të gjakut më të ulët për 7.5%. Përderisa një ulje e qarkullimit të gjakut në këtë nivel nuk nxitë ndonjë simptomë, ekspertët kanë paralajmëruar se është e mjaftueshme për të ndikuar në funksionet kognitive.

Njihuni me SUV-in fantastik spanjoll



Nuk ka dyshim që Seat është fabrikuesi më i madh i automobilave në Spanjë, por kjo nuk do të thotë që në këtë vend mungojnë ndërmarrje më të vogla që i dedikohen botës së makinave dhe nxjerrin në treg modele ekskluzive. DSD Desi-



gn & Motorsport është një nga këto ndërmarrje të vogla dhe projekti i tij i fundit quhet Golem. Bëhet fjalë për një SUV të madh, që pason Boreas, një makinë supersportive hibride. Për momentin, Golemi është vetëm një prototip, por në dhjetor pritet që të nisë prodhimin e tij. DSD Design & Motorsport ka bërë me dije se do të prodhohen vetëm 30 njësi.



Njerëzit e urojnë për binjakët, por ajo është duke vdekur!

Një grua e cila mendonte se ishte shtatzënë me binjakë u trondit kur mjekët i thanë se barku i saj i madh në të vërtetë ishte një tumor gjigant. Barku i Marilyn Felipe nisi të fryhej 7 vjet më parë dhe filimisht ajo mendoi se priste fëmijë. Por kur 39-vjeçarja shkoi tek mjeku, me shpresën e një lajmi të mirë, ajo u trondit kur iu tha se në fakt barku ishte një tumor miomë në qafë të mitrës.

Kjo masë beninje ishte shpërndarë në mitër dhe po shkaktonte fryrje të vazhdueshme. Për 7 vjet me radhë tumor i vijoi të rritej. Për fatin e saj të keq, shpeshherë gruaja ndalohej në rrugë nga njerëzit të cilët nuk e dinë gjendjen e saj dhe e urojnë për shtatzëninë, duke menduar se pret binjakë apo edhe trinjakë. Duke folur nga shtëpia e saj në Maguindanao, Filipine, Marilyn tha: "Do doja shumë të isha shtatzënë, do të bëja festë. Por e vërteta është se jam në këtë gjendje prej shumë kohësh". Marilyn, sipas asaj që shkruan e përditshmja britanike "Mirror", nuk është e martuar dhe nuk ka fëmijë dhe nuk ka mundur t'i nënshtrohet një operacioni që prej vitit 2011 kur u diagnostikua me tumor, për shkak të kostos.

Mjekët i thanë që operacioni në atë kohë shkonte rreth 1500 paund, por me rrogën e saj modeste, gruaja nuk mund ta përballonte. Tashmë ajo ka lënë edhe punën për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe shpreson në një mrekulli që do t'i shpëtonte asaj jetën.



Zhytja në ujë heq stresin

Të kalosh një ditë nën ujë mund t'ju bëjë të ndiheni më të relaksuar, të çlodhur dhe me energji të përtëritura. Ky është konkluzioni i një studimi të kryer nga kërkuesit e Universitetit Curtin dhe publikuar në revistën Health Psychology. Të zhytesh të bën më krijues duke iu shmangur përditshmërisë kaotike. Tingujt e valëve mund të të fusin në një gjendje medituese duke bërë që stresi të shkrihet me kalimin e kohës. Në këtë mënyrë mendjet tona shkojnë në një hapësirë çlodhëse, thuajse hipnotike, falë aromave qetësuese. Të jesh në një vend rrethuar me peizazh të bukur tërësisht blu është tejet qetësuese për shpirtin.



1533 - Papa Klementi VII ka shkri-shëruar Mbretin e Anglisë Henrin VIII.

1673 - Holanda dhe Danimarka nënshkruajnë marrëveshje për mbrojtje.

1740 - Hebrejtë dëbohen nga Rusia e Vogël me urdhrin e Carinës Ana.

1776 - Kapiteni Xhejms Kuk fillon lundrimin e tij të tretë.

1882 - Flota britanike bombardon Aleksandrinë.

1921 - Mongolia fiton pavarësinë nga Kina.

1955 - Kongresi autorizon që në tërë valutën e SHBA të shkruhet "In God We Trust".

1980 - Pengu amerikan Richard I Queen lirohet nga Irani.

1988 - Mike Tyson angazhon Donald Trump si këshilltar.

2011 - Neptuni kompletion orbitën e tij të parë që nga zbulimi i tij më 23 shtator të vitit 1846.



Sipas një studimi të ri, 7.6 miliardë njerëz në botë përfaqësojnë vetëm 0.01% të të gjitha gjallesave. Megjithatë, që nga agimi i qytetërit, njerëzimi ka shkaktuar humbjen e 83% të të gjithë gjitarëve të egër dhe gjysmës së bimëve, ndërkohë që blegtorja e mbajtur nga njerëzit është e pasur. Bakteret janë me të vërtetë një formë jetësore e madhe - 13% e gjithçkaje, por bimët errësojnë gjithçka, që përfaqësojnë 82% të të gjitha materieve të gjalla. Të gjitha krijesat e tjera, nga insektet në kërpudhat, peshqit dhe kafshët përbëjnë vetëm 5% të biomasës së botës.

BIONDJA NË MUZE

Shkon biondina në një muze me famë dhe pa dashje, e rrëzon një vazo shumë të lashtë dhe shumë të vlefshme. Vrapon menjëherë mbikëqyrësi i muzeut dhe fillon t'i bërtas: A jeni ju normal... e keni thyer vazën e vjetër 700 vjet! Biondina me habi ia kthen: Uuhhhh faleminderit që më tregove! Tash po ndihem më mirë, se unë mendova mos ishte ajo vazo e re!

Bëhuni burra! Rrëmbeni kazmat! Puna është më e lartë se trimëria, kazma më fisnike se palla. E mbi të gjitha heshtni!

Jo fjalë, por kazmën. Jo mbledhje, por kazmën. Jo misione, por kazmën! Dhe parmendën, dhe draprin, dhe shoshën, dhe furrën. Mjaft lëvdime. E kam zemrën aq të mbushur me lot sa s'qaj dot.

(FAIK KONICA)



KALENDARI HISTORIK 11 KORRIK



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS